

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6378  
E martë, 3 gusht 2021  
çmimi 0.40

## Para Ambasadës së Shqipërisë kundërshtohet nisma "Ballkani i hapur"

IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# PRITJE MADHËSHTORE PËR KAMPIONET OLIMPIKE



Dy fitueset e medaljeve të arta në Lojërat Olimpikë, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, trajneri Driton Kuka dhe pjesa tjetër e ekipit olimpiq janë pritur me ceremoni shtetërore në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", kurse qytetarë të shumë ishin dalë t'i presin dhe nderojnë heronjtë e tyre. Kryeministri Albin Kurti, pasi i përgëzoi për suksesin e arritur ka thënë se Kosova synon të fitojë tri e me shumë medalje në Lojërat e ardhme në Paris. Kampionët Olimpikë suksesi ia kanë dedikuar popullit të Kosovës



## Kurti: Reciprocitetin me Serbinë do ta vendosim kur të jemi gati

IFAQE 2



## 48 raste të reja me Covid në Kosovë

IFAQE 4



**RENOVA**  
PUTZ  
Kosovë  
Zhytyshkë - Tetovë  
Gatitje-Portland  
Tel: +381 41 487 306 - +381 41 487 309  
+381 41 487 325  
Fax: +381 41 487 300  
Tel: +381 41 501 280

ND, RTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



## ZJARRET KAPLOJNË SHQIPËRINË, KARABURUNI NË RREZIK

F. 2

## RIFAT JASHARI VIZITON NË ZYRË NIPIN, BEKIMIN

F. 7

## KRASNIQI: PDK-JA DO TA VAZHDOJË THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT ME TË GJITHA VENDET MIKE

F. 5



### EKONOMI



## ATK-ja BËN THIRRJE PËR DEKLARIM TË TATIMEVE DHE TË KONTRIBUTEVE PENSIONALE

F. 8

## YMER FEJZULLAHU ZGJEDHET KRYETAR I BORDIT TË ZRRE-së

F. 8

## Zjarret kaplojnë Shqipërinë, Karaburunin në rrezik

TIRANË, 2 GUSHT - Zjarret e shkaktuara nga temperaturat e larta përgjatë gjithë territorit të Shqipërisë janë vënë nën kontroll të hënën pasi autoritetet kanë ndërhyrë për shuarjen e tyre, por gjendja vazhdon të jetë shqetësuese në disa pjesë të vendit, përfshirë bazën ushtarake në Karaburun. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, tha se shuarja e zjarreve ishte e suksesshme dhe se shumica e vatrave janë stabilizuar, por paralajmëroi që, përkundër përpjekjeve të deritashme të 200 forcave të armatosura të zbatuara për ta sanuar gjendjen, zona përreth bazës detare të Pashalimanit vazhdon të jetë e rrezikuar.

“E vetmja vatrë aktive serioze në vend është Karaburuni, ku kemi përqendruar dhe do të vazhdojmë të jemi të përqendruar me mjete ajrore dhe mjete tokësore dhe me forca të shumta”, tha Peleshi. Ministri tha se është arritur të shmanget përfshirja nga flakët e zonës ushtarake të Pashalimanit që gjendet në jug të Vlorës dhe, po ashtu, edhe Parku Kombëtar i Llogarasë është duke u menaxhuar. “Më afër kërcënimeve të zjarreve kanë qenë banesat në zonën e Ksamilit dhe një fshati të Përmetit, por tani ato janë shuar. Në orët e para të mëngjesit është fikur edhe zjarri në Mamuras”, bëri me dije Peleshi.

Ndërkohë, temperaturat e larta dhe erërat që fryjnë e bëjnë të paparashikueshme situatën me zjarre, teksa vazhdon të raportohet për vatra të reja nëpër gjithë Shqipërinë. Deri sot nuk janë rrezikuar vendbanimet, megjithatë, përmes një buletini për rreziqet natyrore të publikuar nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, thuhet se gjatë kësaj jave “pritet nivel ‘i lartë’ rreziku në pjesën më të madhe të qarqeve”. Sipas institutit, qarqet me rrezik më të lartë janë qarqet e Shkodrës, Kukësit, Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës, ndërkohë që Dibra dhe Durrësi janë vënë në kategorinë e moderuar.



## OBSH-ja: Mbi 60 milionë të infektuar me koronavirus në Evropë



Gjenevë, 2 gusht - Që nga fillimi i pandemisë në mars të vitit 2020 më shumë se 60 milionë raste të të infektuarve janë regjistruar në Evropë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka njoftuar të hënën se shifra përbën rreth 30 për qind të të gjitha rasteve të regjistruara në botë.

Zyra Rajonale Evropiane e OBSH-së ka bërë thirrje për më shumë angazhim në fushatën e vaksinimit kundër Covid-19, duke

theksuar pabarazinë e gjerë në furnizimin me vaksina midis disa vendeve.

Megjithatë, normat e vaksinimit në Evropë janë ndër më të lartat në botë.

Drejtori rajonal për urgjencë i OBSH-së, Dorit Nitzan, ka thënë se shumë njerëz që bëjnë pjesë në grupet e para vaksinimit, përfshirë të moshuarit dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor, ende nuk janë vaksinuar.

Në rajonin evropian janë

regjistruar më shumë se 1.2 milion vdekje të lidhura me sëmundjen Covid-19. Në nivel global, sipas të dhënave të OBSH-së, deri më tani numri i viktimave është 4.2 milionë.

Rajoni evropian i OBSH-së mbulon 50 vende, përfshirë Rusinë, Ukrainën, Turqinë dhe të tjera. Edhe brenda Bashkimit Evropian ka pabarazi për furnizim me vaksina. Bullgaria dhe Rumania janë shumë mbrapa vendeve të tjera anëtare.

## Shpëtohen 700 migrantë që tentuan të kalojnë Mesdheun

Tripoli, 2 gusht - Më shumë se 700 persona janë shpëtuar teksa kanë tentuar të kalojnë Mesdheun me anije gjatë fundjavës, ka njoftuar grupi për ndihmë, SOS Mediterranean. Grupi për ndihmë ka thënë më 1 gusht se shumica e personave janë shpëtuar në brigjet e Libisë dhe Maltës.

SOS Mediterranean ka thënë se anija ka kryer gjashtë operacione në ujërat ndërkombëtare prej 31 korrikut.

Migrantët vazhdimisht nisen me

anije nga Libia dhe Tunizia për të arritur në shtetet e Bashkimit Evropian përmes qendrës së Mesdheut.

Kalimi është i rrezikshëm dhe anijet e tejngarkuara shpesh përballen me vështirësi.

Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, 930 migrantë kanë vdekur në Mesdhe këtë vit. Libia është një prej pikave më të shpeshta të nisjes, ndërsa pjesa më e madhe e migrantëve tentojnë të arrijnë në brigjet italiane, rreth 300 kilometra larg.



## Gjermanët protestojnë kundër kufizimeve për koronavirus

BERLIN, 2 GUSHT- Pavarësisht ndalesës për mbajtje të disa protestave, mijëra persona kanë dalë të hënën nëpër rrugët e Berlinit për të protestuar kundër masave për luftim të koronavirusit, përmes së cilave qeveria

gjermane synon të luftojë variantet e reja të këtij virusi. Policia ka thënë se disa protestues kanë “sulmuar” zyrtarët policorë dhe kanë penguar trafikun në kryeqytetin gjerman. Protestat, që janë zhvilluar

edhe në qytete tjera gjermane, kanë ardhur pasi gjyqtarët kanë ndaluar mbajtjen e disa marsheve në këtë fundjavë nga lëvizja Querdenker, e cila ka qenë më e zëshme kundër kufizimeve për koronavirus.



# Para Ambasadës së Shqipërisë kundërshtohet nisma “Ballkani i hapur”

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Organizata Lëvizja për Demokraci ka mbajtur të hënën një aktivitet simbolik para Ambasadës së Shqipërisë në Kosovë përmes të cilit ka kundërshtuar nismën e Edi Ramës për të ashtuquajturin “Ballkani i hapur”. Anëtarë të kësaj organizate mbanin në duar pllakatin që kishte fotografi nga lufta e fundit në Kosovë e që shiheshin krimet serbe mbi popullsinë civile.

Kryetari i kësaj organizate, Mexhid Ramusa, ka thënë para mediave se kundërshtojnë çdo nismë të tillë, pasi Serbia nuk ka kërkuar ende falje për krimet e kryera në Kosovë. Ai ka thënë se janë përkujdesur që kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, t’ia përkujtojnë lidhjet e presidentit serb Aleksandër Vuçiq me kasapin e Ballkanit, Sllobodan Millosheviq.

Ramusa ka thënë se është e pakuptimtë se si kryeministri Rama synon të përfshijë edhe

Kosovën në një “mini-Shengen” ku merr pjesë edhe Serbia. “Në bazë të këtij aktiviteti kemi shprehur pakënaqësitë tona ndaj kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për lidhjet e tij me Vuçiqin, kriminelin serb që ka bërë krime në Kosovë. Ne ia kemi prezantuar të gjitha faktet dhe lidhjet e tij (Vuçiqit) me Millosheviqin, duke kundërshtuar nismën për ‘mini-Shengenin Ballkanik’, ka thënë Ramusa.

Ai ka theksuar se e ardhmja e Kosovës është drejt Bashkimit Evropian dhe jo drejt nismës “Ballkani i hapur”. “E ardhmja jonë është drejt Bashkimit Evropian dhe ShBA-së. Për ne është e pakuptimtë që të hyjmë në një ‘mini-Shengen’ ku është edhe Serbia, e cila na ka vrarë, na ka masakruar dhe ka kryer gjenocid mbi popullatën civile”, është shprehur Ramusa.

Më 29 korrik në Shkup u takuan kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev.



Të tre liderët ftuan vendet e rajonit që t’i bashkohen nismës së “mini-Shengenit” që mori emërtimin e ri “Ballkani i

hapur”. Në këtë takim nuk mori pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Sipas Ramës, Vuçiqit dhe Zaevit, “Ballkani i

hapur” ka për qëllim të krijojë një treg të përbashkët për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

## Vitia: Testet për Covid të ardhura nga Serbia do të asgjësohen

EPOKA  
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në seancën e Kuvendit mbajtur të hënën, ka folur për 1 000 testet që Serbia ia kishte dhuruar si donacion Kosovës gjatë qeverisë Kurti 1. Vitia duke iu përgjigjur pyetjes së deputetit të PDK-së, Bekim Haxhiu, ka thënë se këto teste do të asgjësohen. “Bazuar në të dhënat e IKShPK-së, ato ruhen si shumica e materialeve të tjera dhe nuk janë përdorur asnjëherë. Ato do të trajtohen si materialet e tjera me afat të skaduar. Meqë nuk kërkohen

procedura të veçanta të asgjësimit, kjo nënkupton se do të asgjësohen në mundësinë e parë bashkë me mbetjet e tjera”, ka thënë ai.

Vitia ka thënë se problem është edhe asgjësimi i shumë barërave të cilat janë blerë nga qeveritë e kaluara e që tani janë me afat të skaduar. “Hallin më të madh qeveria e ka me tonelata barëra të cilat kërkojnë procedura specifike për asgjësim, të cilat janë blerë nga qeveritë e kaluara e që, fatkeqësisht, tani janë me afat të skaduar, mirëpo edhe kësaj do t’i bëjmë një zgjidhje”, ka thënë ministri Vitia.

## Lekaj paditë për shpifje zëvendësministrin Durmishi

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka bërë me dije se të hënën ka dorëzuar padi kundër fyerjeve dhe shpifjeve të zëvendësministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, i cili në një emision televiziv e quajti Lekajn ministër

të një “grupi kriminal”. “Janë mësuar tani e një kohë të gjatë të vjellin vrer, me fyerje e shpifje të paskrupullta kundër meje, kudo që kanë pasur mundësi. Bile me këto janë krekosur para popullit edhe si guximtarë, duke u fshehur prapa imunitetit që ofron ligji kundër fyerjes dhe shpifjes për gjithë ato që fliten në Kuvend dhe në komisione

parlamentare nga kushdoqoftë. Duke e parë se mosreagimi im po e nxitë edhe më shumë shpifjen dhe fyerjen kundër meje, vendosa që t’i drejtohem gjykatës. Aty duhet të tregojnë fakte për vërtetësinë e deklaratave të tyre. Tani e tutje ose duhet ta rrudhin gojën ose do t’u rrudhet xhepi”, ka thënë Lekaj.





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI NUK KA HEQUR DORË NGA VENDOSJA E RECIPROCITETIT ME SERBINË

# Kurti: Reciprocitetin me Serbinë do ta vendosim kur të jemi gati

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar se reciprociteti i plotë ndaj Serbisë do të vendoset kur të përgatiten institucionet e Kosovës. Para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ai ka thënë të hënën se qeveria që drejton nuk ka hequr dorë nga ky parim. Sipas Kurtit, Kosova dëshiron që reciprociteti i plotë me Serbinë të bëhet në atë mënyrë që të mos zhbëhet më. Kryeministri Kurti ka bërë me dije se reciprocitetin Kosova nuk e ka për hakmarrje

Shefi i qeverisë ka thënë se për reciprocitetin ka biseduar edhe gjatë takimeve që ka pasur në Bruksel, në kuadër të dialogut me Serbinë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. “Sa i përket reciprocitetit, qysh në dhjetor të vitit 2011 ne e patëm miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës rezolutën për reciprocitet të plotë politik-ekonomik dhe tregtar, saktësisht më 7 dhjetor 2011. Këtë princip unë e kam paraqitur edhe në takimet që i kam pasur në Bruksel. Zëvendësi im i parë Besnik Bislimi ka përgatitur një dokument, në mënyrë të thuktë 11 shkeljet që ia bën Serbia reciprocitetit me Kosovën në raportin tonë të ndërsjellë”, është shprehur Kurti.

Ky qëndrim i kryeministrit ka ardhur pasi deputeti i PDK-së,

Fadil Nura, ka kërkuar nga ai sqarime për këtë çështje. Deputeti Nura ia ka kujtuar Kurtit se kishte deklaruar që vendosja e reciprocitetit me Serbinë do të jetë një prej vendimeve të para të qeverisë së tij. “Gjatë fushatës zgjedhore më 12 shkurt, dy ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, ju u zotuat se reciprociteti do të jetë një nga vendimet e para të qeverisë suaj. Keni deklaruar se ‘reciprociteti do të jetë çështje ditësh ose javësh, kurrsesi muajsh. Nuk e di cila do të jetë sekuenca, por është ndër gjërat e para që do ta bëjmë’. Z. Kurti, për dijeninë tuaj kanë kaluar ditë, javë e muaj. Më saktësisht jem në muajin e pestë të qeverisjes suaj dhe nuk keni ndërmarrë asgjë për masa reciproke”, ka deklaruar Nura, duke e kritikuar qeverinë për largim të masës mbrojtëse për materialet ndërtimore nga

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 2 GUSHT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se nuk ka hequr dorë nga vendosja e reciprocitetit të plotë me Serbinë. Gjatë seancës plenare të së hënës, ai ka paralajmëruar se reciprociteti i plotë ndaj Serbisë do të vendoset kur të përgatiten institucionet e Kosovës për ta zbatuar atë. “Në 100 ditët e para (të qeverisjes) ne kemi pasur drejtor të ri të Doganave

dhe duhet të përgatitemi sepse nuk mund të dështojmë sërish. Ju e dini, në Kurti 1, ne e vendosëm reciprocitetin dhe qeveria e pastajme e hoqi reciprocitetin. Nëse ne nuk arrijmë ta zbatojmë plotësisht reciprocitetin sërish, atëherë ai vdes edhe si koncept”, ka deklaruar Kurti. Sipas tij, Kosova dëshiron që reciprociteti i plotë me Serbinë të bëhet në atë mënyrë që të mos zhbëhet më. “Ne do ta vendosim reciprocitetin dhe këtë do ta bëjmë atë kur të jemi të përgatitur. Ne do ta

vendosim reciprocitetin, por nuk duam të dështojmë”, ka deklaruar Kurti, duke shtuar se parimi i reciprocitetit mes shteteve buron nga koncepti i barazisë. “Reciprocitetin nuk e kemi për hakmarrje. Besojmë se është një parim i shëndoshë i marrëdhënieve midis shteteve, që derivon nga koncepti i barazisë. Përveç kësaj, reciprocitetin nuk e kemi për të shtuar barriera, por për t’i hequr ato ekzistuese dhe duam ta bëjmë në mënyrën në të cilën nuk zhbëhet më”, ka deklaruar kryeministri Kurti.

## 48 raste të reja me Covid në Kosovë

**PRISHTINË, 2 GUSHT (ER)** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka njoftuar të hënën se nga testimi i 2 288 mostrave janë regjistruar 48 raste të infektimit me Covid-19.

Përgjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimitë. IKShPK-ja ka njoftuar se janë shëruar pesë pacientë nga sëmundja Covid-19, ndërsa raste aktive janë 582. Prej 13 marsit 2020, kur janë

regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 108 513 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 266 kanë vdekur, ndërsa 105 665 janë shëruar.



Serbia. "Përkundrazi, e për fat të keq, tani po shohim edhe heqjen e takës si masë antidopingu ndaj blloqeve të ndërtimit që vijnë nga Serbia. Çfarë është duke ndodhur, z. kryeministër?", ka pyetur Nura.

Ndaj paralajmërimeve të Kurti për reciprocitet ka reaguar edhe drejtori i të

ashtuquajturës Zyrë për Kosovë në kuadër të Qeverisë së Serbisë, Petar Petković. Sipas tij, vendosja e masës së reciprocitetit e shkatërron dialogun për normalizim të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Çështja e të ashtuquajturit reciprocitet është në të vërtetë një eufemizëm për ngritjen e

barrierave të reja ekonomike ndaj të cilave u ekspozuan serbët në Kosovë e M. dhe Beograd gjatë taksës anti-civilizëm prej 100-përqindësh. Prandaj për Kurtin do të ishte më mirë që në vend të këtyre paralajmërimeve për hapa të njëanshëm që direkt e shkatërrojnë dialogun, të përkushtohet

përbushjet e marrëveshjeve të arritura deri më tash, sidomos për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", ka thënë Petković, sipas një komunikate të lëshuar nga zyra e tij.

Në fund të vitit 2018 qeveria Haradinaj kishte vendosur taksën 100 për qind ndaj

produkteve serbe. Kjo taksë, në qeverinë Kurti I, u zëvendësua me reciprocitet, ku u përfshin një sërë masash tregtare. Por, qeveria pasuese e udhëhequr nga Avdullah Hoti kishte hequr reciprocitetin, masë kjo që u pa nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara si pengesë për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

## Kurti: Mërgata, pjesë thelbësore e zhvillimit të qëndrueshëm



PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Në shënim të Ditës së Diasporës, kryeministri Albin Kurti ka zhvilluar të hënën bashkëbisedim me mërgimtarë, profesionistë të fushave të ndryshme që po qëndrojnë në Kosovë.

Në këtë bashkëbisedim morën

pjesë zëvendëskryeministrja, njëherësh ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla dhe zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi.

Në hapje të takimit, kryeministri Kurti ka theksuar se qeveria ka

vëmendje të veçantë për mërgatën dhe kjo është reflektuar edhe në programin e qeverisë. Ai ka vlerësuar se mërgata është pjesë vitale e kombit e cila ndodhet jashtë atdheut, por patjetër se është brenda kombit. "Këtë rëndësi kaq të madhe të

mërgatës sonë ne synojmë që ta shndërrojmë në prioritet në qeverisjen tonë në muajt e në vitet në vijim, duke e llogaritur mërgatën si pjesë thelbësore të zhvillimit të qëndrueshëm", ka thënë Kurti. Ai i ka falënderuar mërgimtarët për gjithë

kontributin dhe rolin para, gjatë dhe pas luftës, para dhe pas shpalljes së pavarësisë dhe sot e kësaj dite.

Qeveria e Kosovës do të krijojë një program nacional për transferim të dijes dhe përvojës nga diaspora në Kosovë.

## Krasniqi: PDK-ja do ta vazhdojë thellimin e bashkëpunimit me të gjitha vendet mike

Prishtinë, 2 gusht (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të hënën në takim shefen e Misionit të Ambasadës së Luksemburgut në Kosovë, Natacha Gomes, me të cilën ka biseduar për

bashkëpunimin ndërmjet vendeve tona. "E falënderova për ndihmën e vazhdueshme që Luksemburgu i jep Kosovës me programe të ndryshme, duke përfshirë ato në fushat e shëndetësisë dhe arsimit. PDK-ja si

parti shtetformuese do ta vazhdojë thellimin e bashkëpunimit me të gjitha vendet mike që e kanë ndihmuar Kosovën në rrugën e saj të pavarësisë dhe shtetndërtimit", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".



## Kryetari i Suharekës angazhohet për shuarjen e zjarrit

SUHAREKË, 2 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se zjarret sërish janë

aktive në disa pjesë të Zonës Industriale në Shirokë. Muharremaj është angazhuar vetë për shuarjen e zjarreve.

“Me të gjitha kapacitetet tona, kudo ku po paraqitet e nevojshme, po intervenojmë. Duhet ta kemi parasysh që

bashkë mund t’ia dalim përballë kësaj situatë”, ka shkruar Muharremaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



## Komuna e Malishevës mbështet edhe 30 bujq me shpërndarëse të plehut

MALISHEVË, 2 GUSHT (ER) - Komuna e Malishevës, përmes Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural, sot i ka shpërndarë edhe 30 shpërndarëse të plehut kimik për 30 bujq. Kjo përkrahje bëhet në kuadër të subvencionimit në bujqësi, përmes thirrjes publike për subvencionim me makineri bujqësore. Gjatë shpërndarjes së tyre ishin të pranishëm edhe nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, të cilët i kanë uruar përfituesit dhe kanë thënë se përkrahja e sektorit të bujqësisë do të jetë e vazhdueshme. “Ti gëzoni këto makina të cilat, pa dyshim, do t’ju shërbejnë në punën tuaj për punimin e tokës dhe që janë shumë të nevojshme

për ju, ndërsa komuna gjithmonë do të mundohet që brenda mundësive ta përkrahë sektorin e bujqësisë, pasi investimi në bujqësi do të thotë investim në zhvillim, sepse dega e bujqësisë është dega më e sigurt e zhvillimit ekonomik dhe mundësia më e mirë që kemi”, ka thënë nënkryetari Berisha gjatë shpërndarjes së makinave shpërndarëse të plehut kimik. Nga ana tjetër, drejtori për Bujqësi, Murat Hoxha, pasi i ka uruar përfituesit, ka bërë me dije se edhe ky subvencionim bëhet në kuadër të përkrahjes për bujqit vendas, sipas thirrjes publike për subvencionimin e bujqve dhe, sipas tij, “ky nuk është projekti i vetëm dhe as i fundit, pasi përkrahja për bujqit do të jetë e vazhdueshme”.



## Komuna e Podujevës largon deponitë ilegale, shqipton gjoba për ndotësit e ambientit



PODUJEVË, 2 GUSHT (ER) - Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit, komuna e Podujevës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka filluar largimin e deponive ilegale, ndërsa Drejtoria e Inspeksionit është në terren për të inspektuar dhe shqiptuar gjoba për ndotësit e ambientit. Gjodat mandatore po shqiptohen për të gjithë hedhësit e mbeturinave, qoftë të amviserisë apo të ndërtimit të cilat po hidhen në lumë dhe në hapësirat e tjera, publike dhe private. Po ashtu, gjoba po shqiptohen edhe për ata të cilët hedhin mbeturina në vendet e caktuara për banorët e


komplekseve banesore e të cilët nuk janë pjesë e atyre objekteve ku gjenden kontejnerët. Drejtoria e Inspeksionit ka ftuar të gjithë krijuesit e mbeturinave, ekonomitë familjare, por edhe të gjithë operatorët ekonomikë, të lidhin kontrata me kompanitë për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave në mënyrë që ta evitojnë krijimin e deponive ilegale. Po ashtu, Drejtoria e Inspeksionit ka ftuar qytetarët të jenë partnerë për ruajtjen e mjedisit, duke dërguar dëshmi vizuale në rastet kur hasin në qytetarë të pandërgjegjshëm të cilët shkaktojnë ndotje të ambientit.

## Zbulohet lapidari për ish-ushtarin e UÇK-së Skënder Gashi

RAHOVEC, 2 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, përfaqësues të OVLUÇK-së në Rahovec dhe familjarë, ka bërë zbulimin e lapidarit të ish-ushtarit të UÇK-së, major Skënder Gashi. Kryetari Latifi ka thënë se Skënderi ishte ndër ushtarët e parë të lirisë i cili la rehatinë dhe mirëqenien në Austri dhe u bashkua në radhët e çlirimtarëve në UÇK. “Jeta dhe vepra e tij qenë mbushur



me atdhedashuri dhe në çdo hap e veprim e dëshmoi këtë. Pjesëmarrës në shumë beteja të UÇK-së prej nga doli faqebardhë e i pathyer. Udhëhoqi me përgjegjësi njësitin që i ishte besuar, duke mos iu bërë bisht asnjëherë detyrave luftarake. Si komandant i logjistikës në njësinë e TMK-së në Sallagrazhdë, dëshmoi aftësi dhe kompetencë ushtarake. Skënder Gashi u vra pabesisht nga një dorë tinëzare më 18 shtator 2000,



duke lënë në kujtesë një mori veprash luftarake dhe organizative”, ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se eprori i TMK-së, Skënder Gashi, do të mbahet mend për punët e

mëdha e fjalët e pakta. “Dëshmorët kanë vetëm ditëlindje. Lavdi jetës dhe veprës së dëshmorit të lirisë Skënder Gani Gashi!”, ka thënë Latifi.

# Gjykata mund të sjellë më shumë probleme



PRISHTINË, 2 GUSHT - Në formën si është paraqitur në projektligj, Gjykata Komeriale, sipas shoqërisë civile, do të shkaktonte më shumë probleme sesa zgjidhje për lëndët komerciale në vend. Në bazë të këtij projektligji, që është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 22 qershor, të gjitha kontestet lidhur me çështjet ekonomike dhe konfliktet administrative në kontestet biznesore në të ardhmen do të jenë kompetencë e Gjykatës Komerciale. Por, Rreze Hoxha-Zhuja nga Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS) ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Gjykata Komeriale duhet të jetë pjesë unike e sistemit gjyqësor. Sipas saj, krijimi i kësaj gjykate, në formën

që është paraparë me projektligj, do të krijonte një gjyqësor të shkëputur, që do ta dëmtonte integritetin unitar të sistemit të apelit. "Krijimi i një instance të dytë brenda Gjykatës Komerciale do të kishte të njëjtin rezultat. Opsioni i propozuar për të përfshirë një departament të apelit brenda Gjykatës Komerciale është i ngjashëm me krimin e Divizionit të Apelit në Mitrovicë", ka thënë Hoxha.

GLPS-ja përmes një hulumtimi ka gjetur tri probleme të këtij projektligji: periudha e gjatë kohore e nevojshme për të zgjidhur një mosmarrëveshje (mesatarisht tre vjet), cilësia e pakënaqshme e aktgjyqimeve të shqiptuara dhe struktura

ekzistuese e gjykatës, e cila, sipas studimit, nuk korrespondon me legjislacionin komercial në zhvillim dhe aktivitetin e biznesit privat.

Hoxha-Zhuja ka thënë se thelbi i problemit nuk është struktura ose sistemi organizativ i gjykatës, por mosdija dhe mospuna e gjyqtarëve. "Ne konsiderojmë që një argument i tillë nuk qëndron, meqenëse propozimi për themelimin e Gjykatës Komerciale nuk e zgjidh mosdijen e gjyqtarëve që do të punojnë ose do të angazhohen në këtë gjykatë", ka deklaruar Hoxha-Zhuja.

Projektligji që është miratuar në parim ditë më parë në Kuvendin e Kosovës është kundërshtuar edhe

nga partia opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

## Vokshi: Gjykata Komeriale ka mangësi thelbësore

Kundër themelimit të Gjykatës Komerciale është shprehur edhe avokati Urim Vokshi. Vokshi, që zakonisht punon me biznese, ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se Projektligji për Gjykatën Komerciale ka mangësi thelbësore që mund të ketë pasoja për bizneset që janë në procese gjyqësore. "Kjo ka të bëjë me mjetet juridike, pasi kufizohet ushtrimi i mjeteve juridike të bizneseve, për shkak se ndalohet paraqitja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, pastaj kufizohet e drejta për mjetin e jashtëzakonshëm të revizionit, vetëm për konteste në vlerë mbi 50 mijë euro", ka thënë Vokshi.

Problem tjetër, sipas tij, është dyshkallshmëria e gjykatës. "Në një formë indirekte e cenon të drejtën në mjet juridik të palëve për t'u shqyrtuar ankesa për një organ të pavarur, në rastet kur ushtrohet ankesa në shkallë të dytë, për shkak se prapë do të jetë vetë Gjykata Komeriale e cila do ta gjykojë ankesën e palëve në shkallë të dytë përmes dhomave të shkallës së dytë", ka thënë Vokshi.

## Cili është funksioni i Gjykatës Komerciale?

Që nga viti 2017 Ministria e Drejtësisë ka filluar procedurat për themelimin e kësaj gjykate që parashihet të jetë adresa e vetme për palët që kanë konteste të

natyrës ekonomike. Ushtruesi i detyrës i sekretarit në këtë ministri, Ardian Bajraktari, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo gjykatë në radhë të parë do ta rrisë efikasitetin në shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve të kësaj natyre dhe do ta ngrehë edhe sigurinë juridike të bizneseve. "Rrjedhimisht do të jetë një mekanizëm që do ta përmirësojë klimën e investitorëve potencialë sepse siguria juridike ka qenë dhe vazhdon të mbetet një prej çështjeve që e ka penguar këtë sektor dhe të gjitha këto do të jenë në funksion të ngritjes dhe avancimit edhe të aspektit ekonomik dhe mirëqenies", është shprehur Bajraktari.

Kjo gjykatë do të funksionojë si gjykatë e specializuar, e ndarë në dy shkallë (Themelore dhe të Apelit), kompetente për gjykimin e kontesteve për çështjet komerciale dhe administrative në çështje komerciale, si dhe do t'i trajtojë kundërshtimet dhe ankesat në procedurat përmbartimore. "Gjykata Komeriale do t'i ketë gjithsej 20 gjyqtarë si fillim, të ndarë në dy nivele, 13 prej tyre në nivelin Themelor, ndërsa shtatë në atë të Apelit. Në kuadër të saj do të jetë edhe kryetari i gjykatës i cili me automatizëm do të jetë edhe gjyqtar që do të marrë pjesë në shqyrtimin e lëndëve të kësaj natyre", ka thënë Bajraktari.

Gjykata Komeriale ka funksionuar edhe më herët në Kosovë, deri më 1 janar të vitit 2013. Atëkohë ishte rekomanduar që të kalohet në sistemin aktual të gjyqësorit dhe të ketë një departament të specializuar për çështje ekonomike brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë.

## Rifat Jashari viziton në zyrë nipin, Bekimin

SKENDERAJ, 2 GUSHT (ER) - Rifat Jashari e ka vizituar të hënën në zyrë nipin, kryetarin e komunës së Skenderajt, Bekim Jasharin. "Sot më vizitohet në zyrën time axha im Rifati, njeriu shembull i sakrificës që na mbushi me forcë e motiv në ditët e para të lirisë dhe kështu vazhdon të jetë çdoherë afër nesh dhe punëve të mira që bëjmë", ka shkruar kryetari Bekim Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se mixha Rifat është udhërrëfyesi i tyre i jetës. "Këshillat dhe mësimet e tij për ne dhe gjeneratën e re të familjes sonë janë qenësore në veprimet dhe vendimet që ne marrim. Gjatë këtij mandati qeverisës, në

shërbim të qytetarëve, kam punuar me përkushtim që ta përmbush premtimin që i kam dhënë edhe mixhës që do të punoj me nder, në shërbim të secilit qytetar dhe mirëqenies sociale të tyre. Jam tejet i lumtur që puna ime dhe projektet e realizuara po vlerësohen lart nga mixha Rifat, nga i cili mora përkrahje maksimale edhe për mandatin e dytë në udhëheqje të komunës së Skenderajt, për ta vazhduar angazhimin maksimal në shërbim të vendit", ka shkruar Bekim Jashari, kryetar i komunës së Skenderajt, i cili në zgjedhjet lokale të 17 tetorit do të garojë edhe për një mandat të dytë qeverisës në këtë komunë.



## KEDS-i: Zjarret po rrezikojnë furnizimin me energji për konsumatorët

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia e personave të papërgjegjshëm dhe nga temperaturat e larta që po mbizotërojnë në vend, përpos që rrezikojnë banorët, njëkohësisht po rrezikojnë edhe furnizimin me energji elektrike. KEDS-i ka theksuar përmes një njoftimi se është shqetësuese rritja e vazhdueshme e rasteve ku

sipërfaqe të mëdha pyjore dhe fushore po përfshihen nga zjarret dhe për pasojë konsumatorët tanë po mbesin me orë të tëra pa furnizim me energji elektrike. "Nga këto zjarre, në asetet e KEDS-it po shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale. Për shkak të terrenit pastaj të paqasshëm për makineritë e rënda, ekipet tona po detyrohen që

bartjen e materialit dhe pajisjeve të tjera ta bëjnë duke depërtuar në këmbë, duke e bërë mjaft sfiduese punën. Kjo po ndikon edhe në kohëzgjatjen e punimeve", thuhet në njoftimin e KEDS-it. KEDS-i u bënë thirrje qytetarëve që të jenë të kujdesshëm dhe të mos ndezin zjarre të cilat rrezikojnë furnizimin me energji për konsumatorët.



## ATK-ja bën thirrje për deklaram të tatimeve dhe të kontributeve pensionale

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua rikujtuar të gjithë personave të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar t'i deklarojnë tatimet dhe kontributet pensionale në mënyrë reale.

ATK-ja ka njoftuar se aktivitetet do të përqendrohen pikërisht te kategoritë, si: nëndeklaruesit e pagave të punëtorëve, nëndeklaruesit te bizneset e mesme dhe të mëdha, nëndeklaruesit te bizneset mikro dhe të vogla, me qëllim të identifikimit të atyre bizneseve të cilat nëndeclarojnë të ardhurat e tyre.

Disa nga veprimtaritë në vijim nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK-ja u bënë thirrje që të deklarojnë apo korrigojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe t'i përbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor. "Identifikimi i bizneseve, të cilat nëndeclarojnë pagat e punëtorëve; Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve të cilat bëjnë nëndeclarim, në veçanti veprimtaritë, si: tregti, shërbime, ndërtimtari dhe prodhim; Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve të cilat bëjnë nëndeclarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht nën pragun e TVSh-së, veçanërisht bizneset në veprimtaritë, si: tregti, shërbime profesionale, zbatimëse-artistike, prodhim, transport etj; Identifikimi i bizneseve të cilat operojnë me humbje, si dhe bizneseve që deklarojnë me zero; Identifikimi i bizneseve të cilat



ofrojnë furnizime pa të drejtën e kreditimit të TVSh-së, ndërsa në anën tjetër zbrasin TVSh-në në blerje; Identifikimi i bizneseve të cilat importojnë apo tregtojnë mallra me akcizë, të cilët përmes dokumentacionit jo të saktë, respektivisht nënvlerësimin të çmimeve të shitjes, iu shmangen detyrimeve tatimore", theksohet në njoftimin e ATK-së.

Më tej thuhet se duhet të bëhet edhe identifikimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e tekstit dhe veshmbathjeve të cilat mbajnë dokumentacione jo të sakta me qëllim të shmangies së detyrimeve tatimore. Gjithashtu, edhe identifikimi dhe trajtimi i personave të cilët nuk bëjnë deklaramin e të ardhurave të ndryshme që ata mund të kenë

qoftë të hyrat nga jashtë vendit, të hyrat nga kapitali apo të hyra të tjera. "ATK-ja inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'u përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK do të detyrohet që të ndër marrë masa ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore ju do

të kontribuoni në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore", është thënë në njoftimin e ATK-së.

## Ymer Fejzullahu zgjedhet kryetar i bordit të ZRrE-së

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur kryetarin e bordit të Zyrës së Rregullatorit të


Energjisë dhe dy anëtarë të këtij bordi. Ymer Fejzullahu ka marrë besimin e deputetëve për ta

drejtuar këtë bord me mandat pesëvjeçar, ndërkaq anëtarë janë zgjedhur Lutfije Dërvishi

dhe Gani Buqaj. Fejzullahu ka marrë 64 vota, Dërvishi 65 vota, ndërkaq Buqaj 60 vota.







HAQIF MULLIQI

# BREGU I PIKËLLIMIT, NJË DRAMË E SHNDËRRUAR NË TRAKTAT IDEOLOGJIK DHE KOMBËTAR

*Këndvështrim për dramën Bregu i pikëllimit të Teki Dërvishit në dhjetëvjetorin e ikjes së tij në amshim*

Në vargun e veprave të dramaturgëve që i dhanë fizionomi krijimtarisë dramatike shqiptare nëpërmjet poetikës së simbolizmit dhe një lloj neosimbolizmi, krahas Beqir Musliut, Ymer Shkrelit, Xhabir Ahmetit, Resul Shabanit, Agim Majat, Mehmet Krajës etj., shquhet edhe Teki Dërvishi. Ky autor vjen më vonë në dramaturgjinë shqiptare, me dy drama të shkruara në fund të viteve shtatëdhjetë dhe në fillim të viteve tetëdhjetë: *Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi* dhe *Vrasja në tavernë*. Ato s'arritën të përjetoheshin as nga publiku e as nga kritika. Ai bëri një shpërthim të shënueshëm nga mesi i viteve tetëdhjetë kur botoi dramën e tij më të njohur dhe më të mirë *Bregu i pikëllimit*, e quajtur asokohe dramë nëntërrathëshe. Jo vetëm në rrafshin tematik, por dhe në atë artistik

shkrimtari ia doli ta zgjeronte diapazonin dhe hapësirën e krijimtarisë së tij dramatike, paçka se në dramën e tjera nuk e arriti as së afërmi këtë sukses.

Ç'është e vërteta, periudha kur krijoi Dërvishi format dramatike që aplikoi së bashku me disa dramaturgë të tjerë, gjuha, struktura dhe procedeu që shfrytëzuan, si dhe shumë aspekte të tjera nga literatura dramatike e kësaj periudhe, faktikisht s'u ndërjuan mbi idenë e materies teatrore. Madje, ndonjëherë ajo që solli Dërvishi, apo Musliu, Ahmeti, Shabani, Malaj dhe Kraja e ndonjë tjetër në dramaturgjinë e tyre, shpesh nuk janë as skena teatrore e as veprime dramatike, paçka se veprave të tyre u kanë dhënë forma të dialoguara në materiet tekstuale. Për këtë arsye, ndonjëherë më kot është kërkuar

fuqia e aksionit dramatik apo rekonstrukcioni i ndonjë koncepti të pastër dramatik edhe nga fakti se shumëçka në këto vepra ishte disi më shumë si literaturë prozaike, sikurse një lloj realizmi shpirtëror rrethuar nga botëkuptimi subjektiv i shkrimtarit mbi të vërtetën jetësore. Ky nuk është rasti i vetëm dhe i izoluar por, para së gjithash, qe një ide. Në këtë mënyrë aksioni i përkiste intelektualizmit dhe urtësisë filozofike të vet shkrimtarit. Ndërsa, e tëra, pak a shumë, mbetet si një lloj krijimtarie ndërmjet esesë dhe dramës.

*Bregu i pikëllimit* është një vepër interesante. Shtresimet e saj ajo i ka ndërtuar diku ndërmjet poezisë dhe skepticizmit, sikurse ekzistencës dhe mitologjisë.

Drama *Bregu i pikëllimit* e Teki Dërvishit ka për synim që nga

aspektet negative dhe pasiviteti që kanë pasur historikisht shqiptarët për nëntë shekuj, të krijojë një impuls të ri dhe, përmes formës pasive të veprimtimit dramatik, të nxjerrë në dritë disa nga problemet e mëdha të njerëzimit përmes procesit të të menduarit. Në këtë mënyrë, Teki Dërvishi e ka shndërruar dramën në një lloj traktati ideologjik dhe kombëtar, duke e afruar atë më shumë për nga tezat e caktuara ideore, estetike, politike, etnologjike, antropologjike dhe historike sesa për nga fati i individit, pra fatit të njeriut dhe kolektivitetit të cilit ai i përket. Kështu, pra, prej dramës ai ka krijuar jo një simbol, apo shumë simbolika, por një formë letrare. Për këtë shkak ndodh që nëpër nëntë pjesët e dramës të Dërvishit të krijohet ndjesia se personazhet janë shumë

pak sintetike (e ndonjëherë aspak) dhe, nga fillimi i procesit të tyre të jetuarit, ata sikur bartin diçka shumë të çmueshme me vete, duke bërë përpjekje të jashtëzakonshme për ta fshehur. E për këtë, kur arrihet të merret vesh diçka, kjo vjen si rezultat jo i të vepruarit të personazheve, por i rrafshit narrativ të veprës, i cili, si një prozë e bukur dhe e rrjedhshme, e dominon të gjithën, nga fillimi deri në fund.

Studiuesi Josif Papagjoni shkruan se drama *Bregu i pikëllimit*, në të gjitha pjesët e saj, pra në të 9-tat, thuaja se nis dhe mbaron në portat e metaforës së golgotizimit të shqiptarëve ndër shekuj. Sipas tij, kjo sintezë është *totale, gjithëpërfshirëse: prek fabulën, personazhet, fjalën, porositë autoriale, retorikën dramaturgjike, sidomos situatën emocionale*<sup>1</sup>.

Madje ky studiues mendon se *Golgota* e heroit të dramës të T. Dërvishit *Bregu i pikëllimit* është e mundimshme, sfilitëse, vrastare, si një ankth që s'përfundon asnjëherë<sup>2</sup>.

Mitet e kaluara dhe ato të kotësishë sonë, tregatimi i tyre nëpër kohë dhe veprimi në hapësirë; sprova për çmisticifikimin e idhujve të njëmendtë e të gënjeshtërt, korniza historike, shtresimet shoqërore, dimensionet dhe predimensionet morale dhe etike, sipas një parimi rrethor prej nëntë faqesh, janë disa nga motivet, obsesionet, gjykimet, shqetësimet e shkrimtarit Dërvishit. Të gjitha këto bashkë ai përpiqet t'i kontekstualizojë në bashkëkohësinë e tij, në rrafshin tematik, dhe jo vetëm. Këtu kemi të bëjmë me një vepër dramatike pa fabul të vijueshme, rrëfim kronologjik e karaktere të ndërtuara, të shquara e të personalizuar, duke krijuar një procede interesant në strukturën tematike dhe kompozicionale në rrafshim e rimitizim, gjë e cila ka qenë ambicie dhe shprehje artistike e shumicës së dramaturgëve që kanë krijuar në Kosovë që nga Anton Pashku (në *Sinkopa* dhe *Gofi*) e deri te Nebi Islami (te *Hijesina*).

*Bregu i pikëllimit* i Teki Dërvishit është një dramë që ekstraktin e gjen te balada e moçme mbi Konstantinin dhe Doruntinën, por që, në esencën e vetme të ndjeshme, përpiqet ta semantizojë fatin e artistit në një shtegtim nëntëfaqësh, i cili ndërtohet në mes të ferrit, pa shpresë se do të shpëtohet e të dalë së andejmi. Në këtë dramë imazhi dramaturgjik shëmbëllet me metaforën e kryqëzimit duke krijuar vetvetiu paragoninë ngjethëse të finales së dramës<sup>3</sup> që vjen si një përfundim i paralajmëruar. Në këtë vepër, për të cilën mendojmë se është drama e tij më e arrirë, në vend të konfliktit klasik, Dërvishi ofron gjendjen dramatike, ndërsa në vend të situatave dramatike, një lloj të intrigës metafizike, e në vend të strukturimit dramatik të përmbledhur dhe konciz, një lloj të ligjërimit verbal dhe narracionit eseistik me ç'rast, në pjesën më të madhe të dramës, veprimi dramatik veçse rrëfëhet.

Sikundër thotë N. Islami, kultivimi i dramës në linjën e rimitizimit, që dallon te *Bregu i pikëllimit*, duke marrë diçka edhe nga format e antidramës, në mbështetje të situatave universale të ekzistencës me specifikat e miteve kombëtare, është aspekt që e gjejmë të sforcuar sidomos te dramat e Teki Dërvishit<sup>4</sup>.

### Konteksti ciklik i dramës

Është vërtet interesant syzheu i veprës<sup>5</sup>. Por, para studimit të fenomenit të radhitjes dhe ndërthurjes së motiveve, ku krijohet një numër shumë i madh dhe, po ashtu, shumë interesant i ndryshimeve provokuese, duhet të flasim pak për strukturën e dramës *Bregu i pikëllimit*. Ajo është e ndarë në nëntë pjesë që vijnë si nëntë rathë ferri, apo si e nënta mistike: *Në frytet e urrejtjes*, *Shenja e tmerrit*, *Majat e vetmisë*, *Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi*, *Dritarja* e

*zymtësisë*, *Pritja e ilaçeve*, *Pasqyra e zhgënjimit*, *Lulepjeshkat e dashurisë dhe Bregu i pikëllimit*. Këto pjesë mund të jenë edhe rathë të një trugu familjar, një vorbull miqësore, një kontroversë ndërnjerëzore, një kontradiktë psiko-sociale, një (për)kufizim kohor dhe hapësiror, një qark intelektual, një lloj snobizmi, një neurozë krijuese, apo pusi të vetmisë konstante, një kënetë e mendjes njerëzore, frikë, kaos, apo fanitje amshuese e frikës, një etno-psikologji, një fatum, një ecje në vend, e kështu me radhë, duke paraqitur një kompleksivitet mjaft interesant të veprës veçanërisht në rrafshin semiologjik letrar. Këtu, të nëntë pjesët e ciklit të saj mund të lexohen edhe si një e tërë, ashtu sikurse grupohen në numra të tjerë (kishte përvoja të tilla në shfaqjen *Pritja e ilaçeve* apo edhe *Lulepjeshkat e dashurisë* kur u trajtuan për skenë vetëm disa nga pjesët e bashkëdyzuar të *Bregut të pikëllimit*<sup>6</sup>), ngaqë nuk mungon një lloj mëvetësie organike e pjesëve të dramës, qofshin ato të ndara apo edhe të përbashkuara në një tërësi të vetme. Nga ana tjetër, siç shprehet studiuesi B. Rexhaj, *Bregu i pikëllimit* mund të lexohet edhe në kontekstin e ciklit, pra të përjetohet si një tërësi artistike relativisht koherente<sup>7</sup> duke krijuar një sintezë ndërmjet mitit dhe realitetit. Dhe kjo ndërtohet brenda një teme hiperbolike përmes nëntë tablove, me nëntë palë karaktere që janë dhe s'janë vazhdimësi e pjesës pararendëse të dramës, e mund të jenë apo edhe mos të jenë të tillë. Ndërsa bëhet fjalë për personazhe që identifikojmë përmes unitetit të veprimit dhe kohës e, ndonjëherë, edhe përmes situatave në zhvillime analoge të veprimit dramatik falë veprimit tematik që sillt rreth temës boshtit të vdekjes, të ringjalljes dhe të kërkesës për plotësimin e fjalës së dhënë - besës, apo edhe plotësimin të premtimit dhe zotimit ndaj nënës për kthimin e motrës. Në këtë sferë, besojmë se drama *Bregu i pikëllimit* animon një konglomerat situatash konkrete dhe abstrakte me zhvillime paradoksale, fantastike, mistike, absurde e, ndonjëherë, edhe reale, që mëtojnë ta nxjerrin në pah shumështrësinë dhe shumëdimensionalitetin e ekzistencës si koncept.

Studiuesi dhe shkrimtari Sabri Hamiti mendon se në vepra si kjo e T. Dërvishit alternohen funksionalisht dramatika (të ndodhurit) me didaskalikën (përshkrimin e të ndodhurit). Në fakt, Hamiti mendon se te Dërvishi i gjithë teksti dramatik ndërtohet ndërmjet dialogut që përfaqësojnë personazhet dhe monologut që përfaqëson fuqishëm intencën e autorit. Në këtë mënyrë autori bëhet vetë personazh i veprës dramatike, i artikuluar si vetja e tij apo i artikuluar si tendencë e tekstit<sup>8</sup>. Në këtë pikë është interesant ta kujtojmë edhe mendimin e J. Papagjonit i cili thotë se, ekziston edhe mundësia e leximit të dyfishtë të kësaj drame, dekompozimi i qëllimit të baladës, sikundër edhe këqyrja e rrëfenjës biblike të kryqëzimit të Jezuitit alegori dhe gjasë parake për krijimin

e asociacionit, që lidhet me jetën e personazhit kryesor, i jep veprës një tjetër relief; aspak realist, përkundrazi, surrealist. Situata është thujse apokaliptike, një rrokullimë psikike ku caqet kohore zhduken. Vegimi skenik mjedisor kthehet në një pamje kryepingulthi. Nga njëra anë, Vetan Lojtari që në gjendje kllapie mbart nënën e vet gjysmë të gjallë e gjysmë të vdekur mbi një karrocë morti, nga ana tjetër nëna që s'jep shpirt pa e parë të birin (në zhgënjendër). Në fakt, ajo ka vdekur dhe është varrosur. I biri s'e ka përcjellë dot në banesën e fundit. Ai vetë është një i varrosur. Një kufomë e pakallur. E patretur. Simbol i kësaj ndërnjetme jetë - vdekje, sigurisht. E gjalla dhe e vdekura rrinë së bashku. Drama procedon në një situatë jermi. Kllapia, makthi, tmerr, bëhen indikatorët psikikë të personazheve. Njëkëtë gjendje ndërftuten edhe elementë të përcudnimit, të groteskut. E llah-tarshnja, gjer edhe makabria, pikturojnë skena makthi duke krijuar një shpëshjtellim psikik<sup>9</sup>.

Jemi plotësisht të një mendjeje me studiuesin në fjalë kur thotë se qasja filozofike e autorit bëhet posaçërisht e shfaqshme kur ai vendos të bisedojë në dramë figura me të njohura nga shkrimet biblike dhe kuranore. Falë deduksioneve filozofike që këto shkrime bartin si dhe domethëniet morale të personazheve të mirënjohura që lëvizin aty, arrihet që të pohohen mendime dhe ide me karakter universal, që u takojnë kohëve të moçme po aq sa kohëve të sotme. Përshtypje të thellë më kanë bërë veçanërisht zbulosat moderne të personazhit të Mesisë (Musës) në dialogun me Rabinin te drama *Zbutësi i njerëzve me sy zymrydi*, me ç'rast hasim në shumë zgjuarsi te vet dialogu. Duket sikur kullon një mendim i thellë, i qartë, i prajshëm, që të zhytë në mendime mbi themelet e vet qenies, të mirës dhe të ligës, besimit dhe dyshimit, paqes dhe luftës, vesit dhe virtutit. Një raport midis Hyjit dhe Njeriut. Raporti, i perëndishëm, si urdhrat në pllakat e gurta të Moisiut.

Një prej këtyre shenjave besojmë se ka të bëjë me gjithëpraninë karakteristike të teksteve hyrëse, të cilat ndër veçoritë e veta shfaqin një lloj lirizmi të hutueshëm, por edhe *ekspresion të stërholuar*. Ndërsa struktura e dramës *Bregu i pikëllimit* korrespondon me konceptet metafizike, me rrjedhën kronologjike të ngjarjes dhe veprimit kryesor, duke ruajtur vetëm fabulën e vdekjes dhe të ringjalljes së Konstantinit që nxiton t'ia sjellë nënën së tij Doruntinën. Ky proces rrugëtimi i pafund dhe sjellja e Doruntinës të nëna, për Kostandinin përmbillet nëpërmjet transformimeve dhe metamorfozave të jashtëzakonshme që ai pëson, duke u ricikluar nëpër pjesët e ndryshme të dramës e në tipare të ndryshme siç janë: *Në frytet e urrejtjes* si Demi lojtar; *Shenja e tmerrit* - Udhës lojtar; te *Majat e vetmisë* si Lorik lojtar; te *Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi* si Mumi dhe Kipci i lojtarit; te *Dritarja e zymtësisë* si Konstantin lojtar; te *Pritja e ilaçeve* si Kardhiç lojtar; te *Pasqyra e zhgënjimit* si

Lojtar lojtar; te *Lulepjeshkat e dashurisë* si Zë Lojtari dhe te *Bregu i pikëllimit* si Vetan lojtar.

Në të gjitha këto pjesë, nga e para deri në të nëntën, del se Konstantini, në pajtim me poetikën e mitit, me Doruntinën komunikon herë në mënyrë imagjinare, herë konkrete dhe e njofton për rrethanat, situatën dhe gjendjen në të cilën ndodhet, varësisht nga koha në të cilën vepron<sup>10</sup>. Në udhëtimin e tij, ku jepen epoka të ndryshme, Konstantini përballet me sfida të shumta duke shpërthyer nëpër sprova të mëdha për tejkalimin e të cilave nevojitet fuqi titanësh. Përkundrazi, sfidat dhe sprovat i përballon me fuqinë e mendjes dhe shpirtit të tij, duke tërhequr pas peshën e pafajësisë dhe historisë, me qëllim të ruajtjes së identitetit të tij. Ky personazh mjaft kompleks i dramës së Dërvishit, sikundër thotë edhe profesor Islami, në sprovat e tij kalon mynxyrat prometheiane, por edhe ato të vetë Sizifit<sup>11</sup>, ndërsa pritja e kthimit të tij identifikohet me konceptet filozofike të pritjes që hasen te dramaturgjia e Beketit.

### Ndërtimi eksplicit i unitetit të kohës dhe veprimit në dramë

Përgjatë këtij udhëtimi sa fiktiv aq dhe real, ku ndërthuren mitologjia dhe antropologjia e mbijetesës së një populli, e një vendi dhe e një identiteti, krijohet një strukturë kronologjike në dukje mjaft e qartë, paçka se te drama aty-këtu formësohen e thyhen një mori rregullash të renditjes kohore. Gjithashtu, sendërtohet edhe anakronia narrative e veprës, e cila është pjesë karakteristike në tërësinë e kësaj drame. Autori e koncepton veprën nëpërmjet veprimit nëpër kohë të Konstantinit, veçanërisht në pjesët ku bëhet ndërlidhja mes narratives dhe lojës përmes *anakronisë së shumëfishtë*<sup>12</sup>, apo më saktë të *silepsave kohore*<sup>13</sup>. Me këtë rast krijohet një ballafaqim metafizik. Konstantini udhëton ndër shekuj, vdes dhe ringjallet gjithnjë në trajta të ndryshme, por sipas gjallërimit të epokave ku futet, jeton dhe duhet të mbijetojë. Kështu krijohet një raport edhe në pajtim me rrethanat historike të vendit, me kushtet shoqërore, me marrëdhëniet e përgjithshme në mjedisin ku ai vepron. Në të shumtën e kohës këto marrëdhënie janë mitike dhe historike, por ndërthuren në raporte sa aktuale, aq edhe nëpërmjet *analepsave*, domethënë kthimit mbrapa, në ngjarje të papërfunduar, në një kohë tjetër.

Vetë mënyra e ndërtimit të kohës dhe e veprimit të përgjithshëm në këtë dramë është skajshmërisht eksplicite, me ç'rast secila pjesë ka disa nënndarje të caktuara, përmes të cilave na vjen edhe përcaktimi i saktë i kohës kur ndodh ngjarja. Silepsat kohore janë evidente për shkak të ndërlidhjes tematike të ngjarjeve, nga pjesa në pjesë, përgjatë nëntë fazave të zhvillimit të veprimit dramatik, me ç'rast veprimi, ani pse e ndan ngjarjen jo me vite e dhjetë vjetësh, por me shekuj, vazhdimisht përqendrohet

te personazhi i Konstatinit, i cili jeton, ngjallet dhe, çuditërisht, rimishërohet në veten e tij. Këtu e gjejmë çastin të cili kritiku Musa Ramadani e cilëson si fatin e një krijuesi që vepron në retrospektivë apo introspektivë, çka vjen si një lloj pasqyrimi i aktualitetit dhe si refleksion i reminiscencave historike<sup>14</sup>.

Në fund të cilësdo njësi të kësaj strukture dramatike, nga e para deri në të fundit, hasen edhe anakroni të dyfishta përmes prolepsave analeptike. Duke pasur parasysh se vazhdimi i akcilitës pjesë në dramë, në krye të saj kthehet në fillim të të rrëfyerit, mund të konkludohet se heqja dorë nga kronologjia, veçanërisht në dy apo tri pjesët e para të dramës, rezultun të jetë prolepsë. Kështu, shumë saktëna ofrohet një shikim te pasojat e udhëtimit të gjatë të Konstantinit, pasojat e të cilit do t'i vuajë pikërisht ky personazh, gjegjësisht procedeu dramatik që vihet re qysh në pjesën e dytë. Duke pasur parasysh gjithë strukturën e *Bregut të pikëllimit*, aty bie në sy edhe prania e *prolepsës analeptike*.

E loja me unitetin kohor të veprës përfundon në pjesën e tetë të saj, pasi në pjesën e nëntë dhe të fundit vihet re struktura kronologjike. Mirëpo me këtë nuk duhet ta nënkuptojmë se pjesa e fundit e dramës nuk i përmbahet rrjedhës kronologjike të saj. Procesi i rrugëtimin të *Konstantinit* si dhe situatat dramatike nëpër të cilat përbirohet ai dhe personazhet e tjerë të veprës janë të ngjeshura dhe ruajnë një lloj kontinuiteti nëpërmjet *analepsave*<sup>15</sup>. Këto, para së gjithash, janë të një karakteri të brendshëm, pra intern, ngaqë nënkuptojnë të kujtuarit në kohën kur ky proces psikik përfshihet në kohëzgjatjen e veprimit kryesor. *Analepsat* janë kryesisht parcialet për shkak se me futjen e tyre në vepër, në të shumtën e rasteve nuk vijnë deri te shkrija me tregimin kryesor, porse kryhen para çastit kur veprimi ka mbërritur. Një veprim kësajsoj i Dërvishit te *Bregu i pikëllimit* nuk është vetëm i karakterit stilistik, por përmban në vetvete edhe një karakter intencional, ngaqë është e qartë se *analepsat* asnjëherë nuk mund të jenë në të njëjtin nivel besueshmërie si paraqitjet e menjëhershme (të atypëratyshme) të veprimit, çka na bën ta kuptojmë se në dramë kemi të bëjmë me subjektivizmin e radhitjes të ngjarjeve dhe rrethanave të paraqitura. Ndaj, në këtë mënyrë, lexuesi merr informacionet, por asnjëherë nuk është i sigurt se cila është radhitja e tyre dhe a janë vërtet të besueshme ato. Shembulli se si Dërvishi e ndërton personazhin e Konstatinit dëshmon se shkapërderdhja dhe destabiliteti psikik i tij (shpesh e gjykojnë personazhet e tjerë në këtë pikë) është rezultat i shmangieve të mundshme nga besueshmëritë e shprehjeve. Na del, pra, se edhe funksioni i *analepsës*, në këto raste, është proces i rishqyrtimit të ngjarjeve të mundshme nëpër të cilat riciklohet heroi i veprës dhe jo të kujtuarit apo të rrëfyerit mbi rrjedhën objektive të tij. Ndërsa

rugëtimi i birit për te nëna ngjan si shtegu i jetës te vdekja dhe vice-vesa<sup>16</sup>.

... Nëntë qind vjet më parë u kthye nga Holoni i largët, shkretëtirës së Jordanit, vetë i treti, pasi mbivualet vetminë në shpellat e Marabadit. U fut në shtëpi në ku lindin, po s'e panë e s'e dëgjuan të kthyerin. Të tjerat i dini nga Libri, janë të qarta, figura që të bukura i bën përsëritja. Kur s'ish midis nesh – i shkëlqente mungesa! Prania e tij midis nesh na neveriste. E kuptoi drejt: vetminë e kishte mësuar në terrin e Labirinit të gjallë të Marabadit, por s'e kishte mbivualet! U kthye dhe u shtri në shtratit e tij të vdekjes bashkë me Kobrën! A s'u mjafton kjo atyre që dinë t'i deshifrojnë shenjat? E desha si vëllain, në Sukë kur erdhi ta vazhdonte mbivualet e vetmisë, dhe e përqafova si vëllain. Unë Doktor Adhamudhi jetoj në kohën time, kurse Lojtar Lojtari jeton në të gjitha kohët e shkuara; ai do të jetojë në të gjitha kohët e pritshme, por i mungon gjithmonë kohës së tashme. Kohës së vet. Nuk e dënova unë! Më dënua ta dënoj!<sup>17</sup>

Në këtë përmasë Bregu i pikëllimit vjen si projekt - ëndërr apo le ta quajmë model i mbijetesës në një valle të pafundme e cila, hap pas hapi, epokë pas epoke, duhet të kalojë të nëntë rrathët e Ferrit të Dantes për të arritur në një rrethanë të re gjithë po të skëtërrshme. Dallimi i vetëm është fakti se këtu, nga rishqyrtimi dhe kuptimi i veprës, në thelb asgjë s'ndryshon. E vallja, në parim, del se është një tubim i përsëritur para një fatkeqësie të madhe që mund ta godasë vendin. Vallja e të vdekurve<sup>18</sup>, mbase! Lëvizje dhe valle në proceset e ndryshimeve të mëdha të historisë, me ç'rast personazhet e dramës të Dërvishit mbeten prore në bisht të procesit. Ata s'e

determinojnë dot fatin e vet që kalon nëpër sistola dhe diastola të çuditshme, gjithashtu mbi afreskat e ikonografisë vetjake. E kjo nuk përjashton askënd, madje as atëherë kur personazhet shfaqen me fytyra reale apo me pamje fantazmash, me maska mortore, kipa, përfytyrime, fanitje, fiksione, të vdekur midis të gjallëve, të gjallë midis të vdekurve, të rrembyer jo rrallëherë nga ankthet. Kritiku i dramës dhe teatrit, Musa Ramadani, mendon se të tillë gjithë këta personazhe i bën autoriteti nënshtrues i prindit, autokratizmi i kolektivitetit, despotizmi që rrjedh nga mentaliteti i egër i mjedisit jetësor, madje mentaliteti i një rendi apo sektit, paternalizmi pushtetor, mania e përndjekjes (si Jozef K., p. sh., te *Procesi* i Kafkës), frika nga lindja dhe vdekja, fobia ndaj jetës, frikërat e Thanatosit etj.<sup>19</sup> Një makth të tillë përjeton vetë kryepersonazhi i dramës. Ai e ka të theksuar ndjenjën e hybrisit të vetja, paçka se ndjenja e tij për të drejtën dhe të vërtetën dhe shkalla e lartë e vetëmohimit nuk kuptohen shpesh nga personazhet e tjerë. Ndaj ai e përjeton *katarsisin* qoftë në introspektivë të ngjarjeve, ashtu edhe në retrospektivë të tyre. Dhe këtë e kryen me një përpjekje të paepur e me sens vetëflimori, në një rrjedhë bëmash përplot fatalitet e fantazi, me ç'rast, sikundër kuptohet, vdekja dhe rimishërimi nuk janë pjesë e ikjes dhe e kthimit nga amshimi, por shndërrim, rishndërrim dhe përsëritje.

Shih për këtë, *Konstantini* i Dërvishit shumë herë na përafrohet si një Faust shqiptar ani pse rrethanat dramatike nuk janë mirëfilli historike, por që përbirohen nëpër ngjarje historike e që krijojnë reminishencën filozofike dhe ekzistenciale të nëntë shekujve luftë dhe përpjekje për mbijetesë të një populli. E duke iu referuar kësaj, N.

Islami thotë se ky autor, në temën e sprovave universale, në mbështetje të mistereve absurde, anakronike dhe paradokseve, me theks te miti i flijimit, e që janë disi të estetizuara përmes elementeve shkencëtare të strukturës përmbajtjesore, të shndërruara në sintezë të vullnetit që ngadhënjën mbi sfidat dhe sprovat e jetës së këtejme për t'u ngritur mbi shkatërrimin dhe përtëritur e rikujtuar trajta të reja më të përsosura, është shquar me nivelin e lartë artistik, komplementarizëm, me stil eksitues dhe figuracion tejet të larmishëm<sup>20</sup>.

### Ringjallja sugjестive e intelektualit

A ekziston ndonjë dallim në të konceptuarit e *Faustit* të Dërvishit dhe prototipit të tij, apatrid, mesjetar? Te *Fausti*<sup>21</sup> burimor mund të sjellim ndërmend faktin se ai e ka shitur shpirtin të djalli, ndërsa T. Dërvishi me mjaft inteligjencë gjen personazhin që i përngjet atij, duke e marrë nga i njëjti motiv mitik, por ndryshe nga Fausti, ai ka si qëllim jo ta shesë, por ta blejë shpirtin e vet të djalli. Ndaj dhe rruga e Konstantinit zgjatë me shekuj dhe assesit nuk merr fund, ngaqë djallin është e vështirë ta vësh në lojë apo në sprovë.

Duke analizuar personazhet kryesore të dramës *Bregu i pikëllimit* të Teki Dërvishit lexuesi e kupton se ata, përveç Nënës dhe Doruntinës, në trinitet me Konstantinin, falë të cilit risematizohet miti i *Konstantinit dhe Doruntinës* e për të cilat ky vdes dhe ringjallet, udhëton ndër shekuj dhe përballet me lloj-lloj rreziqesh e lloj-lloj vdekjesh, të gjithë faktikisht jetojnë në një orbitë tjetër, në atë të fantazisë së tij. Ata vijnë si zana, shtojzovalle, shtriga, korba, nimfa, apo forma të ndryshme idhujsh, fantazmash, shpirttrash, qenie të simbolizuara mitike, shtriga,

meduza, hije, por edhe si figura që i kemi ndeshur në historinë e shqiptarëve siç janë: Dasareti, Priami a ndonjë tjetër, bashkë me të tjera figura që vijnë nga bota e klerit-murgj e murgësia, ose personazhe që vijnë nga bota reale, ajo poetike e ajo fiktive e shqiptarëve me ndikime të ndryshme në vetëdijën e tyre, në identitetin e tyre, në fatin e tyre në përgjithësi. Këta i ndeshim në një e më shumë pjesë të *Bregut të pikëllimit*. Fatin e tyre autori e tërheq ndër shekuj e shekuj midis rënive dhe ngritjeve historike.

Në një mënyrë apo tjetër, në botën e këtyre personazheve përmbledhen gjithë dilemat psikologjike, morale dhe etike si dhe përcaktimet karakteristike të përfaqësuar nëpër shumë individualitete nga historia jonë e gjatë, e lavdishme, tragjike, e dhembshme dhe groteske në periudhën nëntëshekullore të ecjes herë syçelur e herë symbyllur për të arritur aty ku vetë dramaturgu shndërrohet në një kronist të të gjitha kohëve. Nëpërmjet Konstantinit si strumbullar i veprës, Dërvishi ia del që në një mënyrë të çuditshme dhe sugjестive ta ringjallë intelektualin e rebeluar. I ashpërsuar përmes vuajtjeve të tij, me mëdyshjet dhe dilemat e një mëtimi që ecën vertikalisht, ai shndërrohet në shembullin e kundërshtimit të botës së pushtetshme e të dhunës, aty ku ai paraqitet - në cilëndo kohë dhe në cilëndo shoqëri. Qasja filozofike e autorit bëhet posaçërisht e shfaqshme kur ai vendos të bisedojë në dramë me figura të njohura nga shkrimet biblike dhe kuranore. Falë deduksioneve filozofike që këto shkrime bartin si dhe domethëniet morale të personazheve të mirënjohura që lëvizin aty, arrihet që të pohohen mendime dhe ide me karakter universal, që u takojnë kohëve të moçme po aq sa edhe kohëve të sotme<sup>22</sup>.

Gjithashtu, gjakimi për idealin dhe harmoninë, për fisnikërimin mendor dhe shpirtëror të njerëzve nëpër periudha të ndryshme kohore e historike, për drejtpeshimin individual dhe kolektiv, na shfaqet në formën e sendërtimit të ambicieve e synimeve shoqërore kombëtare të shqiptarëve përgjatë nëntë njësive dramatike të veprës së Dërvishit, të cilat kundrohen po aq edhe si nëntë rrathët e ferrit të *Komedisë hyjnore* të Dante Aligerit. Sipas autorit, Ferri është vendi i ndëshkimit të çdo dhune, e cila ushtrohet ndaj Krijuesit, të afërmeve dhe vetvetes dhe ku sistemi moral i Ferrit është një shkrirje e kujdeshme e teologjisë së krishterë me etikën pagane<sup>23</sup> dhe ku *Etikae* Aristotelit shërben si burim i parë. T. Dërvishi përpiqet, në një mënyrë apo tjetër, ta ndjekë këtë strukturë dhe këtë koncept filozofik mbi jetën, ngaqë në mënyrë të përngjashme me vizionin e Dantes për botën e përtejme, ai përshkohet nga besimet e vona të ndërthurura me paganizmin. Ferri është i mbushur me qenie të mitologjisë antike: Fati, Gjigantët, Minosi, Cerberi, Flegjasi, Karonti etj. Atai gjemë edhe te vepra e Dërvishit përmes figurave të tilla si: shtrigat, zanat, shtojzovallet, nimfat, fantazmat, shpirtat, qeniet e simbolizuara mitike - Meduza, siluetat etj. Kështu pra, mitet e të kaluarës dhe të sotmes, rrezatimi i tyre nëpër kohë dhe veprimi në hapësirë, sprovat për çmiftifikimin e idhujve të njëmendtë e të rremë, korniza historike, shtresimet sociale, dimensionet etike sipas një parimi ciklik, janë disa nga motivet, shqetësimet, obsesionet, tragjizmat e komizmat njerëzore që projektohen në dramën e Dërvishit<sup>24</sup>.

Problemin më të madh ky autor e kishte te dilema - cilën nga dikotomitë do të qëndër të dramës së tij gjatë ndërtimit të saj si



dramë me ind të veçantë letrar. Në këtë pikëvështrim jemi të mendjes se te drama *Bregu i pikëllimit* shquan, më së pari, dikotomia e natyrës së vetë njeriut çfarë përkufizon edhe ekzistimin kalimtar të tij sa në formën e materies, sa në atë të idesë, aq dhe të arsyes, falë të cilave sendërtohet pafundësia, përkatësisht amshimi në nëntë njësitë e dramës: *Shenja e tmerrit, Majat e vetmisë, Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi, Dritarja e zymtësisë, Pritja e ilaçeve, Pasqyra e zhgënjimit, Lulepjeshkat e dashurisë dhe Bregu i pikëllimit*.

### Analiza e frekuentimit narrativ në dramën *Bregu i pikëllimit*

Nga këndvështrimi ynë, në rrafshin tematik dhe semiologjik drama *Bregu i pikëllimit* merr konotacionet e një drame të ndërtuar mbi bazamentin e fantazmagorisë, sepse brenda saj gjemë edhe elemente të epitet dramatik - të dramës së huaj dhe asaj kombëtare. Brenda vetes ajo sublimon martiriumet dhe sfidat e mëdha të shumë periudhave kohore e historike, që nga antikiteti e deri në bashkëkohësinë e dramaturgut. Në mënyrë të trishtueshme aty shpërfaqen kthesat dramatike të një vendi dhe të një kombi, ngritjet dhe rëniet e tij nëpër cikle historike e shoqërore të ndryshme. Sakaq, në konceptin poetik të vdekjes, ringjalljes dhe rivdekjes së Konstantinit, bartësit të fjalës së dhënë ndër shekujt e trazuar, del në skenë me një qartësi të guximshme për kohën e botimit të dramës, arketipi i shqiptarit të përvuajtur, i shqiptarit të vranë, i shqiptarit feniks, të ringjallur nga hiri i tij; pra i shqiptarit që ka energji të fshehta diku brenda vetvetes, por që nuk është i vetëmjaftueshëm. Dhe duke jetuar brenda misterit të mbijetesës së çuditshme, ai bën përpjekje që të ngrihet dhe të vë dorë mbi të keqen, sikurse dhe mbi veten, në cilëndo epokë të pasqyrimit dramatik.

### KORBI I ZYMTË (Demit Lojtar): Ai i hape sytë?

**DEMI LOJTAR:** Paskam parë ëndërr, o Zot! Çfarë ëndërr! (I bie në sy Shtatorja e Strallit). Po kjo? Nga na doli? Kush je ti?

### SHTATORJA E STRALLIT: Ta solla Kutinë e barnave.

**KORBI I ZYMTË (Demit Lojtar):** Këtë kobër gruajë do ta njohësh njëzet vjet me radhë.

**DEMI LOJTAR (Bën me dorë kah veriperëndimi):** Në Sukë pashë pusin e thellë... dy puse i pashë. Njëri ka ujë të ftohtë, tjetri gjarpërinj. (Shtatorja e Strallit). Nga cili pus dole? Kur u imunizua gjaku im ndaj helmit të gjarpërinjve, mora të zbres poshtë, në pusin e parë, pa

ujë, në pusin me shllinga. Njëzet vjet me radhë rashë teposhtë pusit, rrum njëzet vjet. Tash ju gjeta këtu. Të një fare jeni. Po më hutojnë maskat që vini e çirni; ia dilni të shndërroheni prej njeriut në gjarpër. Më mashtroni me zërin e Zogut Gënjeshhtar, Shpotitësit, Tallësit. E ndiej pezmin e tokës nën shputat e mia. Merimangat vënë rrjeta gurëve të pusit nga bie që njëzet vjet dhe qullen eshtrat e mia. Që njëzet vjet po zbres teposhtë pusit me shlligë.

### SHTATORJA E STRALLIT: Të pashë me sytë e mi.

**KORBI I ZYMTË (Shtatorja e Strallit):** Do të niset rrugëve përsëri, ndonëse ende s'iu bënë njëzet e katër orë që ia behu këtu.

### SHTATORJA E STRALLIT (Demit Lojtar): Po vij me ty<sup>25</sup>!

Në strukturën e komplikuar të veprës së Dërvishit, si marrëdhënie e përsëritjeve të pareshtura në nivelin e rëfimit dramatik, por edhe në rrafshin diskursiv, vjen edhe të frekuentuarit narrativ në formën e plotë të saj, të të gjithë tipave, siç e përshkruan edhe Zh. Zhenet<sup>26</sup>. Në këtë pjesë, pra, do të bëjmë përpjekje që përmes disa shembujve ta dëshmojmë ekzistimin e këtyre tipave në dramë, si dhe arsyet e aplikimit të frekuentimit të caktuar narrativ, po ashtu edhe efektshmërinë që autori ka synuar të arrijë.

Së pari te drama *Bregu i pikëllimit* gjejmë formën e të rëfyerit singular si forma më e përfaqësuar. Nga shumësia e ngjarjeve që ndodhin brenda dramës e që shënojnë kthesë në jetën e personazheve, gjithsecila syresh ndodh vetëm njëherë. Për shkak të bindshmërisë së tyre si dhe ndryshimit të shpeshtë e të shpejtë me ngjarjet e reja, del se nuk ishte e nevojshme që të konstatoheshin shumë herë në rrafshin e narracionit dramatik. Përcaktimi për këtë mënyrë të të rëfyerit në dramën<sup>27</sup> e Dërvishit arsyetohet edhe me vazhdimësinë e ndërrimit të kohës dhe vendit ku zhvillohet ngjarja, sikurse me veprimin dhe lëvizjen e vazhdueshme të personazheve nëpër to. Në këtë mënyrë përparimi i shpejtuar nuk lë shumë hapësirë e mundësi për përsëritjen e saj apo edhe rëfimitin nga narratori, që në pjesën më të madhe të *Bregut të pikëllimit* është protagonist i dramës, Konstantini, pavarësisht se ç'emër bartë në cilëndo pjesë.

Shembull tjetër që të sjellim është ai i kalimit fizik, psikik dhe emocional të Konstantinit nga një njësi e dramës në tjetrën e që do të thotë nga një çast historik e shoqëror në tjetrin. Doemos gjen pjesë, siç është, p. sh., kalimi nga *Majat e vetmisë* të *Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi*; aponga *Pasqyra e zhgënjimit* te *Lulepjeshkat e*

*dashurisë*, të cilat mbeten më shumë në nivelin e pjesëve të palidhura sesa që krijojnë një fotografi të plotë të dramës.

Një tjetër gjë që duhet parë në dramë është rëfimi të cilin Zh. Zhenet e quan *Rëfimitativ*<sup>28</sup>. Ai është i pranishëm në të gjitha variantet e saj: në ato ekstere, në ato iterne si dhe në ato pseudo-iterative<sup>29</sup>. Iteracioni i jashtëm apo ekstern, ka kuptimin e përsëritjes narrative të ngjarjeve singulare<sup>30</sup> në segmentet e shkurtra të këtij teksti dramatik. Ai vjen me karakteristikat më të plota në çastet e shpërthimeve të fuqishme emocionale të personazheve që në dramë janë të shumta. Ndërsa rëfimitin dhe kthimin i kujtesës së personazheve (para së gjithash i Konstantinit) te ngjarjet që kanë ndodhur në një periudhë tjetër kohore, shquhet nga tensioni dhe shqetësimet psikike të vet këtij personazhi, sikundër dhe të personazheve të tjerë që kanë të bëjnë me të. Ndaj dhe këtu është i pranishëm një lloj i iteracionit ekstrem: Ndjenja që ka Konstantini se është i vetëm, se është i braktisur, i kërcënuar, pa liri, e bashkë me këtë edhe variacioni që e rikthen në kujtime dhe rëfimitin ngjarjesh paraprake, të cilat përsëriten në mënyrë të vazhdueshme në segmente të shkurtra të tekstit. Një gjasë e tillë vjen si rezultat i shqyrtimit që Dërvishi përpjek të bëjë Lojtarit në procedimin e veprimit dramatik. Lojtari s'mund tëndalojë që të mendojë, pavarësisht nga distancat e gjata kohore që vendosen ndërmjet dy apo edhe më shumë pjesëve të dramës. Ky shembull është tregues i nevojës së përdorimit të determinimit të caktuar (të themi, kohën e shkuar, shekullin e shkuar etj.), por edhe i specifikimeve të papërcaktuara. Përkëtë arsye ekstensionin e ngjarjeve paraqitet shumë i vogël, por jo i tipit momental.

### Vërejtshmëria e pseudoiterativit

Këtu flasim edhe për *iteracionin inter*, i cili vërehet më pak në dramën *Bregu i pikëllimit* të Dërvishit, para së gjithash për shkak të ndërrimit të vazhdueshëm të ngjarjeve, gjë që e vështirëson dallimin e këtij lloji të frekuentivitetit dramatik.

... E në vdekshim, - pohohet diku në finale, do të vdesim në krahun e djathtë, në krahun e punës e tënderit. Frika nuk është pema ime. Unë jam njeri. Unë do të bëhem njeri. Pasi të vdes do të lindem njeri, njeri, njeri, njeri<sup>31</sup>.

Shembulli në fjalë është nxjerrë nga diskursi narrativ i dramës *Bregu i pikëllimit* mbi idenë dhe qëllimin e Konstantinit, si Konstantin lojtari. Në rastin konkret ai është dëshmi për përsëritjen e ngjarjeve. Këtu narratori, i cili, sikurse u tha, është vetë kryepersonazhi i veprës, e merr këtë funksion veçse në këto pika dramatike, pra funksionin e rëfimitarit. Këtu bie në sy fakti se personazhet e Dërvishit përmes një rrugëtimiti të gjatë historik,

pavarësisht nga shndërrimet e tyre, më shumë duket se kanë pësuar kur përcaktohen në krah të njëjës palë sesa të mund të ishin më fleksibilë dhe ta shqyrtonin rrethanën ku gjendeshin, mbase edhe të mbanin një pozitë neutraliteti.

### Konstantin Lojtari: (Kokës së idhullit) A të kam parë diku?!

**Koka e Idhullit:** Po. Dikur moti, u takuam, diku në breg të një liqeni ngjyrë pelikani. Asaj dite një plimz galemash ra nga qielli e m'i nxori sytë. Ti, o Konstantin Lojtari, m'i vure pastaj këto dy copa zymrydi në gropëzat e përgjakura të syve dhe unë përsëri zura të shoh<sup>32</sup>.

Në dramë është vështirësuar të vërejturit e *pseudo-iterativit*, meqë kjo nuk ofron shumë mundësi për zbulimin e tij në tekst, sikundër edhe në tekstet e tjera përgjithësisht. Në shembullin vijues shihet se si, pavarësisht nga aspekti imagjativ, vihet në pyetje një ngjarje e shkakuar nga impulsi apo edhe ngacmimi i çastit. Megjithatë, është e qartë (r) përsëritja e problematikës që rishfaqet nga e para: në ringjalljen e vazhdueshme të Konstantinit, ringjallje kjo që nuk simbolizon kurrfarë ngadhënjimi, përkundrazi martirizmin shembullor të tij, madje si një model frymëzues dhe shumështrësor nga Marabadi e deri në Sukë, duke zgjuar të tjerët çështjet madhështore, pa pyetur për koston që do të ketë ky akt. Ai shprehet se *gjithnjë i mbuloj pësimet me lëkurën time*<sup>33</sup>.

Edhe pjesa *Pasqyra e zhgënjimit*, ku nga narratori i dramës që vjen tanimë si Lojtar lojtari, vë në shënjestër dr. Adhamudhin. Lexuesi krijon bindjen se doktori fantazmagorik aktual e i lugatosur nuk bën gjë tjetër veçse me shpirtngushtësinë e tij të pashoqe dhe me mungesën e vizionit dhe identitetit, këmbëngul që t'i ruajë trajtat e së kaluarës, pa të cilat ai do ndihej si një peshë mbi rërë dhe pa ujë. Adhamudhin e kap trishtimi nga fjalët e Lojtarë lojtarit. Nga aspirata e tij për t'i iluminuar mendjen Adhamudhit, ai përpjek t'i rrefejë misionin dhe rrugën që ka ndjekur, por Adhamudhi te Konstantini nuk sheh gjë tjetër veçse një njeri morbid apo një mostër që ngrë lart shpresën për të arritur dikur-diku në cakun e pritshëm përmes sfidave që u ka bërë dhe shpreson t'ua bëjë kohëve si dhe vetë vdekjes. Për këtë arsye, mendon N. Islami, Adhamudhi i qaset Lojtar lojtarit me thënien bizare: *Do të të qihet nëna sot, por hajt se e ke amshimin e lavdishëm*<sup>34</sup>.

Mund të themi se kategoritë e determinizmit, të specifikimit dhe të ekzistencës përcaktohen mjaft drejt, ani pse mundësia e iteracionit<sup>35</sup> vetëm se është paralajmëruar, dhe jo plotësisht e në mënyrë eksplicite e


vërtetuar. Ndërsa kthimi i Konstantinit në Sukë në mënyrë të pareshtur, nga pjesa në pjesë, faktikisht e vërteton këtë.

### Marrëdhënia dramatike ndërmjet personazheve dhe struktura jolineare e tekstit

Besim Rexhaj mendon se nëse dramën *Bregu i pikëllimit* do ta analizojmë në mënyrë krahasimtare përmes strukturës së romanit, kryepersonazhi i saj luan rol të dyfishtë, ngaqë ai herë vjen si personazh veprues, herë si bartës i veprimit pozitiv e herë si rëfimitar. Ky çast tregon arsyen se përse ka një prani aq të madhe të autorit në vepër, jo vetëm te kryepersonazhi, por edhe te personazhet e tjera<sup>36</sup>. Në parim roli i dialogut në dramë konceptohet si mjet për përshpejtimin e veprimit. Ai ka për synim t'i kumtojë faktet dhe t'i bartë informacionet nëpër periudha të ndryshme kohore, nga një epokë historike dhe shoqërore në tjetrën, ku dhe ciklohet kryepersonazhi i veprës. Po ashtu, Dërvishi synon që përmes këtij dialogu të krijojë marrëdhënie ndërmjet personazheve, paçka se është shumë e vështirë, ndonjëherë e perealizueshme. Apo edhe ta zbulojë konfliktin dhe gjendjet emocionale të tyre si dhe të rrefejë e interpretojë vetë veprën e tij, ku, siç thekson B. Rexhaj, hetohet dora e tij, prania e tij e madhe aty e që është arsyeja, pse dialogu te *Bregu i pikëllimit* është ndonjëherë statik, çka do të thotë se ai nuk i shmanget dot atij ndryshimi mekanik të pyetjeve e përgjigjeve, ku autori mëton të bëhet herë prokuror e herë avokat i personazhit të Konstantinit a Lojtarit. Madje ka çaste kur dialogët, sa i përket marrëdhënies dramatike ndërmjet personazheve, në një strukturë jolineare të tekstit, nuk vijnë gjithnjë si shprehje e karaktereve. Personazhet e Dërvishit jo pak herë rrefehen ndaj dhe zbulohen përmes dialogut e më pak përmes veprimit e situatave ku ata ndodhen<sup>37</sup>.

Dialogu në *Bregun e pikëllimit* mëton që më së tepërmi të jetë reproduksion i së vërtetës qoftë ajo filozofike, politike, etnike, antropologjike, shoqërore a letrare. Dhe, një mënyrë e këfillë e vendosjes së dialogut në një vepër dramatike ka jo pak pjesë të parëndësishme, fjalë dhe gjëra të tjera të panevojshme. Dialogu në dramë duhet të ishte shumë më i shkurtër dhe më i qartë. Kështu, duke e lexuar atë të krijohet përshtypja se në ndërtimin e dialogëve autori ka përdorur së tepërmi stilin letrar, pa e akceptuar mësimin mbi dialogët e dramës se: *mendimet që shkruhen dhe fjalët që i flasim nuk përzgjidhen në mënyrë të njëjtë*<sup>38</sup>. Ndërsa, e tëra mund të interpretohet në mënyrën e vet. Pra, nëse tërhiqet një vijë ndarëse ndërmjet dramës si materie për t'u vendosur në skenë dhe fjalës artistike dhe, nga ana tjetër, nëse elementi i teatralitetit në mënyrë imanente gjendet në esencën e tekstit dramatik si lloj specifik i diskursit letrar, atëherë është e qartë se ndër përcaktimet bazike të strukturës së tij gjuhësore vjen edhe dikotomia ndërmjet





QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Pritje madhështore për kampionet olimpike

Dy fitueset e medaljeve të arta në Lojërat Olimpikë, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, trajneri Driton Kuka dhe pjesa tjetër e ekipit olimpike janë pritur me ceremoni shtetërore në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", kurse qytetarë të shumë ishin dalë t'i presin dhe nderojnë heronjtë e tyre. Kryeministri Albin Kurti, pasi i përgëzoi për suksesin e arritur ka thënë se Kosova synon të fitojë tri e me shumë medalje në Lojërat e ardhme në Paris. Kampionët Olimpikë suksesi ia kanë dedikuar popullit të Kosovës



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 2 KORRIK** - Ekipi i xhudos është rikthyer të hënën në Kosovë, ku është pritur e nderuar fuqishëm nga institucionet shtetërore dhe nga qytetarë të shumtë që dolën t'i presin në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", por edhe në Sheshin "Zahir Pajaziti". Dy kampionet e Kosovës që fituan medalje të arta, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova së bashku me trajnerin Driton Kuka, kryetarin e Federatës së Xhudos së Kosovës, Driton Kuka dhe kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi janë pritur në aeroport nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti. Në konferencën për medie në aeroportin "Adem Jashari", kampionet olimpike janë shprehur të lumtura për suksesin e arritur në "Tokio 2020". Ndërsa kryetari i FXHK-së, Agron Kuka ka thënë boshti dhe shtylla e ekipit është Majlinda Kelmendi, derisa trajneri Driton Kuka është çelësi i suksesit.

"Boshti dhe shtylla e ekipit edhe pse nuk e kishte ditën e saj më të

mirë, Majlinda Kelmendi mbetet një dhe e vetmja, e para. Tanimë ajo është një udhërrëfuese për sportistët tani dhe në të ardhmen. Dua publikisht ta përgëzoj për rezultatet, punën përkushtimin çelësin e të gjitha të arriturave të këtyre, mjeshtrin e madh Toni Kukan", ka thënë Kuka, i cili lavdëroi edhe Akil Gjakovën dhe Loriana Kukën.

Ndërsa në konferencën për media foli edhe kryetar i KOK-ut, Ismet Krasniqi. Ai ka thënë se Kosova u njoh ndërkombëtarisht pas fitoreve të saj në Tokio.

"Kosova me tri medalje të arta. Për mua është kënaqësi e veçantë dhe privilegj t'i prijë një ekipi të tillë që na beri krenarë gjithë shqiptarinë. Kosova në Tokio ka qenë temë e diskutimit nga gjithë bota. Kosovës atje iu shtua një emër: Kosova e artë. Jemi ndierë krenar. Falënderojmë Majlinda Kelmendin që e ka hap derën për sportistët e Kosovës dhe u ka tregu që nëse punojnë mund të arrijnë shumë", ka thënë Krasniqi. Ekipi olimpike me pas mori rrugën drejt kryeqytetit, ku në sheshin "Zahir Pajaziti" sërish janë pritur nga kryeministri Kurti, i cili i shoqërojë deri në binë. Kurti në fjalën e tij para

kampionëve olimpike dhe qytetarëve të shumtë që ishin mbledhur për t'i nderuar sportistët që i sollën Kosovës medaljet e reja olimpike, ka thënë se në Olimpiadën e parë në Rio, Majlinda solli medaljen e parë ndërsa në të dytën në Tokio, Distria dhe Nora bënë histori. Numri një i qeverisë pret që në lojërat e ardhshme olimpike në Parisë Kosova të fitojë tri e me shumë medalje. "Kjo është dëshmi se më përkushtim është gjithçka e mundur. Kampionet në tatami, kampionet në jetë, kampionet në gjithçka. Në Olimpiadën e parë në Rio, Majlinda solli medaljen e parë kurse në Olimpiadën e dytë për Kosovën në Tokio, Distria e Nora bënë histori duke sjellë dy medalje të arta. Medaljet e arta, krahas talentit kërkojnë disiplinë e motivim, taktikë e teknikë të përsosur. Tashmë, të gjithë e dimë emrin e trajnerit të medaljeve olimpike. Ai është trajneri i artë, Driton Kuka që me këmbënguljen e tij, na bëri të gjithëve t'i kthejmë sytë kah xhudo. Tri medalje të arta nga tri gra, për të dëshmuar barazinë gjinore. Faleminderit vajzave, dhe të gjithëve që punuan për

suksesin. Në Rio fituam një medalje, në Tokio dy dhe tani të fillojmë përgatitjet për tri e me shumë medalje në Paris", ka thënë Kurti.

Ndërkohe trajneri Driton Kuka është emocionuar pas pritjes së jashtëzakonshme që i është bërë ekipit fitues në "Tokio 2020". Kuka në fjalën e tij ka thënë se Kosova pas sukseseve të arritura i tregoi botës se e ka merituar lirinë. "Është kënaqësi që pas asaj që ndodhi në Rio që i ka tregu botës që ne si popull e kemi merituar lirinë, një liri e fituar me shume sakrifica, por gjithmonë është Majlinda ajo që i ka hap dyert për Kosovën. Ndërsa këtë e kanë vazhduar Distria dhe Nora. Ato kanë qene candidate për medalje, por dy të arta si kam prit as unë. Do të vazhdojmë me suksese në çdo lami. Teksti po humb por emocionet e bëjnë të veten", ka deklaruar Kuka. Sportistja Distria Krasniqi e ka fitua medaljen e dytë të artë në Lojërat Olimpikë në histori të sportit të Kosovës, pasi të parën e kishte fituar Majlinda Kelmendi në Lojërat Olimpikë në Rio. Distria ka vlerësuar se Majlinda me punën e saj ka dëshmuar se në jetë gjithçka është e

mundshme, pro duhet vetëm një punë e madhe dhe e palodhshme. "Falënderoj shumë për këtë mikpritje kaq të ngrohtë. Po ndihem shumë e gëzuar që i kam sjell Kosovës medaljen e artë olimpike. Majlinda me punën e saj më kanë bërë me besuar që gjithçka në jetë është e mundur dhe kam punuar fort dhe sot jam para jush si kampione olimpike. Ajo pati edhe një mesazh për të rinjtë kosovar. "Ju kisha inkurajuar të gjithëve me punuar shumë për ëndrrat e tyre se gjithçka është e mundur. T'i gëzojmë këto medalje olimpike të gjithë së bashku", ka deklaruar Krasniqi. Ndërsa kampionia e tretë olimpike në histori të shtetit të Kosovës, Nora Gjakova ua ka dedikuar medaljen e artë të gjithë popullit të Kosovës. "Faleminderit krejt popullit të Kosovës që jeni kaq të mrekullueshëm. Nuk besoj që ndonjë kampion olimpike tjetër është prit kaq ngrohtë. Ja ku jam këtu para popullit shqiptar me medalje olimpike. Kjo është për juve", ka thënë Gjakova. Pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" ishin edhe Majlinda Kelmendi, Loriana Kuka dhe Akil Gjakova nga sporti i xhudos.



## Covidi e lë me pasoja Celinën, mungon tre muaj

**DJON, 2 GUSHT** - Futbollisti i Kosovës, Bersant Celina, ka probleme serioze. 24-vjeçari nga Prizreni po përballlet me disa probleme shëndetësore me

zembrën dhe i duhet të pushojë të paktën tre muaj. Mesfushori ishte prekur nga Covid-19, që i ka shkaktuar futbollistit një infeksion perkardit. Celina, i cili aktualisht

është pjesë e Dijonit në Francë, do të mjekohet në shtëpinë e vet në Norvegji, ndërsa më pas do të bashkohet me klubin francez. "Bersant Celina ka probleme të

njëta me Covid-19 me disa komplikime të nivelit të zembrës. Ne nuk duhet të rrezikojmë", ka thënë trajneri David Linares për faqen zyrtare të klubit.



## Sonte takohen Shqipëria U18 - Kosova U18

**PRISHTINË, 2 GUSHT** - Basketbollistët e Kosovës U18, pas përgatitjeve në Prishtinë, të dielën udhëtuan drejt Tiranës, aty ku të hënën e zhvilluan stërvitjen e parë për FIBA European Challengers. Garat zhvillohen nga 3 deri më 8 gusht. "Dardanët" e rinj janë në grup me Shqipërinë dhe Moldavinë, në grupin tjetër janë Luksemburgu, Andorra, Gjibraltari dhe Malta. Sfidat e parë për Kosovën do të jetë më 3 gusht ndaj Shqipërisë në Tiranë. Ndeshja zhvillohet me fillim nga ora 19:00 dhe transmetohet në "YouTube" dhe faqen zyrtare të FBK-së në "Facebook". Më 4 gusht takohen Shqipëria dhe Moldavia, kurse më 5 gusht Kosova do të përballlet me Moldavinë nga ora 19:00. Dy kombëtaret e para kualifikohen në gjysmëfinale, kurse vendi i tretë do të luajë për pozitat 5-7.



dita e diel kanë filluar përgatitjet intensive për FIBA U16 European Challenger. Ky kampionat do të zhvillohet në Prishtinë, nga 16 deri më 21 gusht, andaj është shumë i rëndësishëm për dardanët e rinj, por edhe Federatën e Basketbollit të Kosovës. Stërvitjet po zhvillohen dy herë në ditë, derisa po udhëhiqen nga përzgjedhësi i kësaj grupmoshe, Dritëro Sefaja. Kosova është në grup me

Luksemburgun, Shqipërinë, Gjibraltarin, Moldavinë dhe Maltën. Bordi i FIBA Evropës i besoi FBK-së të organizojë edhe një ngjarje si ky kampionat, kurse më herët kishte organizuar Kampionatin Evropian, Divizioni C për meshkuj U18 dhe Kampionatin Evropian, Divizioni B për femra U18, si dhe 'Bubble', ku morën pjesë Kosova A, Sllovakia, Islanda dhe Luksemburgu të meshkujt.

### Kosova U16 fillon përgatitjet intensive

Pas shumë grumbullimeve, basketbollistët e Kosovës U16 nga

## Shpërthen skandali në Fshatin Olimpik në Tokio

**TOKIO, 2 GUSHT** - Disa atletë rrezikojnë të përballen me ndëshkim pasi janë kapur duke pirë alkool brenda Fshatit Olimpik në Lojërat Olimpikë 2020 në Tokio. Drejtori i përgjithshëm i Lojërave Olimpikë "Tokio 2020", Toshiro Muto, ka konfirmuar se një numër atletësh janë parë duke pirë alkool në një park brenda Fshatit Olimpik të shtunën mërzë. Derisa pirja e alkoolit nuk është e ndaluar brenda Fshatit, atletëve u lejohet ta bëjnë këtë vetëm brenda dhomave të tyre private dhe jo në vende të zakonshme apo publike. Sipas "Insidethegames.biz", atletët e përfshirë në këtë skandal mund të përballen me masa disiplinore.



"Natën e 31 korrikut shumë atletë dhe anëtarë të delegacionit ishin në park brenda Fshatit dhe pinin alkool", ka thënë Muto. "Ne jemi duke e hetuar rastin dhe bazuar në rezultatet, do të

ndërmarrim masa të duhura", ka shtuar ai. Ndëshkimi më i madh që atletët mund ta marrin është përjashtimi nga Lojërat Olimpikë. Megjithatë, ata pritet të gjobiten.

### SHKURT

#### Begolli, trajner i ri i Vëllaznimit

KF Vëllaznimi ka arritur marrëveshje me trajnerin Granit Begolli i cili njihet si futbollist, drejtor sportiv dhe trajner. "Në klub priten projekte të mëdha. Së bashku me kryetrajnerin Begolli do të përpiqemi të organizohemi sa më mirë për zonin 2021/22", thuhet në njoftimin e klubit. Gjithashtu, kuqezinjtë njoftojnë se në ditët në vazhdim priten transferime të reja të lojtarëve. Skuadra nga Gjakova garon në Ligën e Parë të Kosovës dhe padyshim se e kërkon rikthimin në elitën e futbollit të Kosovës.

#### Arteta: Xhaka do të qëndrojë tek Arsenalit

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka njoftuar se Arsenali do t'i ofrojë kontratë të re Granit Xhakës. Arteta për "Talksport" ka thënë se "Granit Xhaka do të qëndrojë me ne. Ai është lojtari kyç i skuadrës sonë". Sipas Fabrizioo Romano, Arsenali i ofroi një kontratë të re Granit Xhakës deri në qershor 2025 me një pagë më të lartë, ndërsa janë të sigurt se do të arrijnë t'ia rinovojnë kontratën, pasi hodhën poshtë ofertën e Romës, 12 milionë euro plus tre milionë shtesë.

#### Leonard nuk e vazhdon kontratën me Clippersat

Kawhi Leonard thuhet se nuk do të vazhdojë të mbetet pjesë e LA Clippers. Sipas Shams Charania, Leonard ka refuzuar kontratën e re të ofruar nga Clippersit. Basketbolli është duke refuzuar të përfitojë 36 milionë dollarë me marrëveshjen e re të ofruar dhe thuhet se do të jetë lojtar i lirë. Mbetet të shihet e ardhmja e njërit prej basketbollistëve më mirë në NBA, ndërsa priten shumë transferime gjatë ditëve në vijim. 30-vjeçari është pjesë e Clippersit që nga viti 2019, ndërsa sezonin e kaluar ishte më i miri në ekip me mesatare 25.8 pikë, 6.7 kërcime. 5.0 asistime për ndeshje.

#### Ronaldinho: Jam i lumtur kur e kam topin në këmbë

Legjenda braziliane Ronaldinho ka thënë se ai ndihet më i lumtur më së shumti kur e ka topin e futbollit në këmbë. Ronaldinho ka lënë shumë kujtime në mendjet e tifozëve të Barcelonës, Paris Saint-Germainit dhe Milanit gjatë karrierës së tij të shquar. Duket se braziliani kishte marrë kujtime të shumta pozitive gjatë kohës si futbollist profesionist, siç ka treguar në një intervistë së fundmi ku foli për karrierën e vet. "Është e vështirë ta zgjedh vetëm një çast" ka thënë Ronaldinho për Ibai Llanos, i pyetur se cili ishte çasti më i mirë në karrierën e tij. "Kur e kam topin jam i lumtur. Kam kujtime të bukura nga secili klub në të cilin kam luajtur. Nuk mund ta veçoj vetëm një", ka shtuar ai. Duke folur për lojtarët të cilët e marrin atë si shembull, legjenda braziliane i nxiti ata të dalin në fushë dhe ta shijojnë lojën. "Shijojeni lojën dhe mësoni", ka deklaruar ai.

## Kaos në Premierë Ligë, futbollistët refuzojnë vaksinimin

Klubet e Premierë Ligës janë të shqetësuar se lojtarët që refuzojnë të marrin vaksinën Covid-19 mund të prishin fillimin e sezonit. Federata Angleze e Futbollit ka bërë të detyrueshëm vaksinimin e lojtarëve dhe stafeve teknike. Të gjitha

skuadrat duhet të vaksinohen deri më 1 tetor, në të kundërt ata nuk mund të jenë pjesë e kampionatit. Megjithatë këtë rregull e kanë kundërshtuar disa futbollistë. Ata nuk kanë pranuar të marrin doza kundër koronavirusit. Për momentin vetëm dy klube të

elitës së futbollit ishullor e kanë mbyllur procesin e plotë të vaksinimit. Një gjë e tillë mund ta sjellë edhe shtyrjen e sezonit, pasi në disa ekipe janë konfirmuar lojtarë me Covid-19. Disa klube kanë shtyrë edhe përgatitjet parasezonale për

shkak të infektiveve. Nga 16 gushti rregullat do të ndryshojnë në Angli. Ata që janë të vaksinuar plotësisht do të duhet të raportojnë vetëm teste negative në mënyrë që ta shmangin izolimin. Sezioni i ri i Premierë Ligës do të nisë më 13 gusht.



### RISHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Pozita:</b>	Administrues i bazave të të dhënave (zyrtar i lartë)
<b>Departamenti:</b>	Teknologjia Informativë
<b>Divizioni:</b>	Teknologjisë Informativë dhe Sistemeve
<b>Grada:</b>	5
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informativë dhe Sistemeve

Administruesi i bazave të të dhënave krijon, instalon, konfigurim dhe administron bazat e të dhënave të bazuara në Oracle dhe MS SQL Server, dhe ofron shërbime shfrytëzuesve që përdorin aplikacione bankare dhe jobankare.

#### Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Administron bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen në Departamentin e Teknologjisë Informativë;
- Planifikon krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave. Punon ngushtë me administratorët e sistemeve gjatë instalimit të aplikacioneve të cilat lidhen me bazat e të dhënave;
- Instalon versione të reja të databazave dhe veglave të saj, si dhe veglave të tjera të nevojshme për qasje në baza të të dhënave;
- Vlerëson versionet e databazave, veglave ndihmëse, në mënyrë që të sigurojë se baza e të dhënave punon sipas standardeve. Në bashkëpunim me administratorët e tjerë dhe zhvilluesit e aplikacioneve, planifikon përditësime me ndikim minimal në punën e sistemeve;
- Administruesi i bazave të të dhënave është edhe pikë kontakti me Oracle dhe Microsoft Support, si dhe kompanitë tjera që kanë aplikacione dhe baza të të dhënave në BQK;
- Shkruan procedura (Ang. "stored procedures") të cilat përdoren për nxjerrjen e raporteve nga bazat e të dhënave në MS SQL Server dhe Oracle;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të databazave;
- Rregullon problemet e ndryshme në bazat e të dhënave, aplikacioneve, komunikimin në mes tyre dhe veglave të tjera të cilat raportohen nga shfrytëzuesit;
- Monitoron dhe në rast të problemeve, rregullon problemet me komunikim në mes të databazave dhe aplikacioneve të ndryshme;
- Konfigurim bazat e të dhënave për "high availability";
- Planifikon, implementon dhe teston në mënyrë të vazhdueshme procedurat për backup dhe restore të bazave të të dhënave;
- Kryen proceset e EOD (End of Day) pas mbylljes së orarit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqës-i/ja.

#### Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri të shkëlqyeshme në administrimin e bazave të të dhënave të bazuara në Oracle dhe MS SQL Server;
- Njohuri të shkëlqyeshme në dizajnimin logjik dhe fizik të bazave të të dhënave;
- Aftësi të kryej rregullime në performancën e bazave të të dhënave;
- Të jetë i aftë të ofrojë strategji gjatë zhvillimit të bazave të të dhënave;
- Shkathësi të shkëlqyeshme në shkrimin e query të ndryshëm sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të drejtave të shfrytëzuesve të bazave të të dhënave;
- Përvojë në migrime të bazave të të dhënave;
- Njohuri në performancë tuning të bazave të të dhënave;
- Përvojë në T-SQL apo PL/SQL;

#### Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Shkallë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose certifikime profesionale për Microsoft SQL: MCSA: SQL Database Admin, MCSA: SQL Server, Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP);
- Përvojë 2 vjeçare në administrimin e bazave të të dhënave;
- Gjuha angleze e preferuar.

#### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

#### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **17 Gusht 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



### PONAVLJANJE OGLASA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

<b>Pozicija:</b>	Administrator baze podataka (viši službenik)
<b>Departman:</b>	Informaciona tehnologija
<b>Odeljenje:</b>	Informacione tehnologije i sistema
<b>Stepen:</b>	5
<b>Izveštava kod:</b>	Rukovodioca Odeljenja Informacione tehnologije i sistema

Administrator baze podataka kreira, instalira, konfigurise i upravlja bazama podataka zasnovanim na Oracle i MS SQL Server, i pruža usluge korisnicima koji koriste bankarske i nebankarske aplikacije.

#### Odgovornosti i dužnosti rada:

- Administrira baze podataka za aplikacije razvijene u Departman za informacionu tehnologiju;
- Planira stvaranje i održavanje baza podataka. Blisko saraduje sa sistemskim administratorima prilikom instaliranja aplikacija koje se odnose na baze podataka;
- Instalira nove verzije svojih baza podataka i alata, kao i druge alate potrebne za pristup bazama podataka;
- Procenjuje verzije baza podataka, pomoćnih alata, kako bi se osiguralo da baza podataka radi u skladu sa standardima. U saradnji sa drugim administratorima i programerima aplikacija, planira ažuriranja sa minimalnim uticajem na učinke sistema;
- Administrator baze podataka je takođe kontakt tačka sa Oracle i Microsoft Support, kao i drugim kompanijama koje imaju aplikacije i baze podataka u CBK;
- Zapisuje uskladištene procedure (Ang. "stored procedures") koje se koriste za izdvajanje izveštaja iz baza podataka u MS SQL Server i Oracle;
- Piše dokument sa uputstvima za upotrebu baza podataka;
- Reguliše različite probleme u bazama podataka, aplikacijama, komunikaciji između njih i drugim alatima koje korisnici prijavljuju;
- Nadgleda i u slučaju problema rešava probleme u komunikaciji između različitih baza podataka i aplikacija;
- Konfigurise baze podataka za "high availability" - „visoko dostupnost“;
- Kontinuirano planira, sprovodi i testira procedure za izradu rezervnih kopija i obnavljanje baza podataka;
- Izvodi EOD (End of Day) procese nakon zatvaranja rasporeda;
- Obavlja druge zadatke koje mu je dodelio rukovodilac.

#### Potrebna znanja:

- Odlično znanje u upravljanju bazama podataka zasnovanim na Oracle i MS SQL Server;
- Odlično znanje iz logičkog i fizičkog dizajna baza podataka;
- Sposobnost prilagođavanja u učinku baze podataka;
- Biti u stanju da pruži strategije prilikom izrade baza podataka;
- Odlične veštine pisanja različitih query u skladu sa potrebama i prirodom posla;
- Dobro znanje o upravljanju pravima korisnika baze podataka;
- Iskustvo u migracijama baza podataka;
- Znanje o performance tuning baza podataka;
- Iskustvo u T-SQL ili PL/SQL;

#### Kvalifikacije i potrebno iskustvo:

- Univerzitetska diploma (bachelor) u oblasti računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili stručni certifikati za Microsoft SQL: MCSA: SQL Database Admin, MCSA: SQL Server, Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP);
- 2 godine iskustva u administraciji baza podataka;
- Poželjno je engleski jezik.


#### Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije / organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo MONT mora službeno priznati / nostrifikovati;
- Dokazi o identitetu i o stalnom prebivalištu na Kosovu;


#### Procedura apliciranja:

- Rok za apliciranje je **17 Agust 2021** godine.
- Apliciranje se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



### Njoftim për tatimpagues Deklaro saktë tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar të deklarojnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te kategoritë, si: Nën-deklaruesit e pagave të punëtorëve, nën-deklaruesit tek bizneset e mesme dhe të mëdha, nën-deklaruesit te bizneset mikro dhe të vogla, me qëllim të identifikimit të atyre bizneseve, të cilat nën deklarojnë të ardhurat e tyre.

Disa nga veprimtaritë në vijim, nuk zbatohen këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të deklarojnë apo korigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor:

- Identifikimi i bizneseve, të cilat nën-deklarojnë pagat e punëtorëve;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim, në veçanti veprimtaritë, si: tregti, shërbime, ndërtimtari dhe prodhim;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht në kuotën fikse prej 37.5€ në çdo 3 muaj;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht nën pragun e TVSH-së, veçanërisht bizneset në veprimtaritë, si: tregti, shërbime profesionale, zbatimëse-artistike, prodhim, transport, etj;
- Identifikimi i bizneseve, të cilat operojnë me humbje, si dhe bizneseve që deklarojnë me zero;
- Identifikimi i bizneseve të cilat ofrojnë furnizime pa të drejtën e kreditimit të TVSH-së, ndërsa në anën tjetër zbrasin TVSH-në në blerje;
- Identifikimi i bizneseve të cilat importojnë apo tregtojnë mallra me akcizë, të cilët përmes dokumentacionit jo të saktë, respektivisht nënvlërësimit të çmimeve të shitjes, i'u shmangen detyrimeve tatimore;
- Identifikimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e tekstit dhe veshmbathjeve, të cilat mbajnë dokumentacione jo të sakta me qëllim të shmangies së detyrimeve tatimore, etj;
- Identifikimi dhe trajtimi i personave, të cilët nuk bëjnë deklarimin e të ardhurave të ndryshme që ata mund të kenë qoftë të hyrat nga jashtë vendit, të hyrat nga kapitali apo të hyrat tjera.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndër marrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Paguj tatimin, fuqizo shtetin!

Administrata Tatimore e Kosovës

# RESTAURANT



# SWISS

# TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË




# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](https://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hysni Zajmi" Gjakovë
- ▶ Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Feraset Asllani, Berjahë Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.M.M.U. "Bajram Sadriu" Berjahë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i l-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**PASHTETË PULË**

gluten  
free



100% mish pulë



**cilësi e garantuar**

pa konservues